



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 18/2021 (JR)
Datë 14.04.2021

Vendim nr. 4 (JR)
Datë 30.01.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

Ina Rama	Kryesuese
Rezarta Schuetz	Relatore
Albana Shtylla	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar
Mimoza Tasi	Anëtare

- mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 30.01.2024, ditën e martë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, me Sekretare Gjyqësore Ina Xhetani, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Mariana Shegani (Dedi), me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 350, datë 23.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë; neni F/7 i Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 63 dhe 66/1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi Gjykses i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Rezarta Schuetz, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Mariana Shegani (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar detyrën e gjyqtares pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Për shkak të këtij funksioni, bazuar në nenin 179/b, pika 3 të Kushtetutës dhe në nenin 3, pika 16 të ligjit nr. 84/2016, ajo iu nënshtroa procesit të rivlerësimit *ex officio* në bazë të shortit të hedhur nga Komisioni më datë 16.02.2019.
2. Për subjektin e rivlerësimit, nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), janë zhvilluar hetime për të tria kriteret e rivlerësimit dhe bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 44 të ligjit nr. 84/2016 janë administruar raportet e kontrollit/vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”).

2.1 ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit raportin përfundimtar¹, duke konstatuar se: (i) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin*; (ii) *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (iii) *ka kryer fshehje të pasurisë*; (iv) *ka kryer deklarim të rremë*; (v) *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

2.2. DSIK-ja i ka përcjellë Komisionit raportin² mbi kontrollin e figurës duke konstatuar se nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose persona të dyshuar të krimit të organizuar, si dhe ka konstatuar *përshtatshmërinë* e subjektit të rivlerësimit, znj. Mariana S. Shegani, në detyrën e gjyqtares në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2.3. KLGj-ja ka hartuar Raportin³ për analizën e aftësive profesionale bazuar në: formularin e vetëdeklarimit dhe tri dokumentet ligjore të përzgjedhura nga subjekti; të dhënat e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; pesë dosje gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor dhe të dhënat nga burimet arkivore të KLGj-së.

¹ Shkresë nr. {***} prot., datë 30.10.2018.

² Shkresë nr. {***} prot., datë 31.10.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. {***}, datë 27.10.2020, të KDZh-së.

³ Shkresë nr. {***} prot., datë 12.10.2020.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Me vendimin nr. 350, datë 23.02.2021, Komisioni ka vendosur: *Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Mariana Shegani (Dedi), gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë. [...].*
4. Vendimi i Komisionit për subjektin e rivlerësimit Mariana Shegani është marrë bazuar në kriteret e vlerësimit të pasurisë, kontrollit të figurës dhe në vlerësimin e aftësive profesionale, për të cilat është konkluduar se:
 - a) *Për kriterin e vlerësimit të pasurisë: (1) Për pasurinë apartament me sipërfaqe 113 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarin të pamjaftueshëm, si dhe rezultoi të jetë në pamundësi financiare në shumën 1.677.838 lekë, për të paguar dy këstet e para të kësaj pasurie. (2) Për pasurinë apartament me sip. 45,5 m², në {***}, Kavajë, subjekti ndodhet në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, pasi rezultoi në mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 1.354.372 lekë, për të justifikuar pasuritë dhe shpenzimet e kryera ndër vite. (3) Për pasurinë automjet tip “Citroen DS3”, subjekti ndodhet në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, pasi rezultoi me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në shumën 966.243 lekë.*
 - b) *Për kriterin e kontrollit të figurës, rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Mariana Shegani (Dedi), ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës.*
 - c) *Për kriterin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit është “i aftë”, duke arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.*
5. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni konkludoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e kriterit të pasurisë, sipas parashikimit të pikave 1, 3 dhe 5, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe në pikën 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, duke vendosur dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

III. Shkaqet e ankimit dhe analizimi i tyre

6. Kundër vendimit të Komisionit ka ushtruar ankim subjekti i rivlerësimit duke kërkuar nga Kolegji, ndryshimin e vendimit nr. 350, datë 23.02.2021, të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë.
 - 6.1. Subjekti i rivlerësimit pretendon se përfundimet e Komisionit nuk janë në pajtueshmëri me aktet dhe provat e administruara, janë anashkaluar dhe nuk janë përdorur në përlllogaritjen financiare prova me rëndësi vendimtare në nxjerrjen e konkluzioneve finale, është zhvlerësuar praktika e krijuar prej vetë Komisionit në shumë raste analoge, nuk është respektuar parimi i barazisë në rivlerësimin e subjekteve, është cenuar e drejta për t’u dëgjuar dhe janë shpërfillur standardet e gjykimit me objektivitet e vërtetësi.
 - 6.2. **Lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 113 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë**, subjekti i rivlerësimit pretendon që konkluzioni i Komisionit se motra dhe anëtarët e familjes së saj nuk kanë pasur mundësi t’i jepnin hua shumën prej 2.000.000 lekësh, e cila ka

shërbyer për pagesën e dy kësteve të para për blerjen e apartamentit, është i pabazuar. Gjithashtu, subjekti pretendon se Komisioni në mënyrë flagrante nuk ka përfshirë në analizë të ardhurat e përfituara nga puna/pensioni i babait të saj në vlerën 836.440 lekë, duke mos marrë në konsideratë provën⁴ e dorëzuar në Komision më datë 09.12.2020.

6.3. Sipas subjektit, mosdeklarimi në deklaratën e rivlerësimit të pasurisë (në vijim deklarata *vetting*), por edhe në deklaratën e personit që mbart detyrimin për deklarim (në vijim DPV 2003) i shumës prej 2.000.000 lekësh dhënë nga motra e saj në vitin 2002, është një pakujdesi e paqëllimtë e mospasjes së asnjë lloj dyshimi mbi ligjshmërinë e burimit, si dhe duke e konsideruar si një ndihmë dhe shfaqje e solidaritetit familjar. Sipas subjektit, kredia e marrë në ish-Bankën Amerikane përbënte burimin e vetëm për blerjen e apartamentit dhe nëpërmjet shumës së kredituar ka likuiduar motrën dhe shoqërinë sipërmarrëse për pjesën e mbetur të papaguar të çmimit.

6.4. Subjekti i rivlerësimit në përfundim të analizës për këtë pasuri, pasi paraqet në formë tabelare të ardhurat dhe shpenzimet e familjes së saj të origjinës (nëna, babai, motra dhe vëllai), për periudhën 1991-2003, pretendon se familja e saj ka pasur gjendje 2.285.790 lekë, duke provuar kështu, sipas saj, se shuma e dhënë prej tyre, për pagesën e dy kësteve të para në vlerën 17.000 USD, është krijuar me të ardhura të ligjshme familjare.

6.5. Lidhur me pasurinë apartament me sipërfaqe 45,5 m², në {*}, Kavajë,** subjekti i rivlerësimit pretendon se të ardhurat në investimin e kësaj prone i ka deklaruar si ndihma nga anëtarët e familjes që në deklaratën e parë të pasurisë të vitit 2003, ashtu edhe në deklaratën *vetting*. Subjekti e konsideron të gabuar konkluzionin e Komisionit, sipas së cilit të ardhurat nga qiraja nga prindërit (nëna) e bashkëshortit nuk mund të merren në konsideratë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare, duke sjellë për subjektin pamundësi financiare në shumën 1.354.372 lekë për të investuar në këtë pasuri.

6.6. Sipas subjektit, konkluzioni i Komisionit është nxjerrë duke anashkaluar parashikimet ligjore dhe provat vendimtare në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi:

- i) provat e paraqitura në Komision vërtetojnë se nëna e bashkëshortit të saj e ka dhënë pronën e saj me qira në vitet 1994-1998, me çmim mujor 2000 USD/muaj, për llogari të subjektit gjerman {***} ({***});
- ii) të ardhurat nga qiraja janë përfituar në një periudhë të hershme kohore dhe, rrjedhimisht, personi i lidhur nëna e bashkëshortit nuk e ka ruajtur kontratën e qirasë dhe as pala qiramarrëse, subjekti “{***}”, nuk e ka mohuar zhvillimin e kësaj marrëdhënie qiraje, por shpreh pamundësinë e tij për të vënë në dispozicion dokumentacionin, për shkak të kalimit të afatit 10-vjeçar të ruajtjes;
- iii) ka shteruar të gjitha mundësitë ligjore për të provuar në mënyrë të plotë ekzistencën e kësaj marrëdhënie qiraje, duke zhvilluar komunikim me “{***}”, duke caktuar ekspertë të fushës për të provuar çmimin e qirasë në kohën kur është zhvilluar marrëdhënia;

⁴ Vërtetimin nr. {***}, datë 09.12.2020, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë.

- iv) ka ezauruar dhe garantuar çdo kërkesë ligjore, ka paguar dhe detyrimin tatimor, duke mospërrjashtuar mundësinë që ky tatim mund të jetë paguar nga qiramarrësi në periudhën e qirasë.

6.7. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni ka mbajtur një praktikë kontradiktore në analizimin dhe vendimmarrjen e çështjeve të ngjashme⁵, duke cenuar haptazi parimin kushtetues të barazisë para ligjit, për të cilin Gjykata Kushtetuese ka prodhuar një jurisprudencë⁶ të vlefshme.

6.8. **Lidhur me pasurinë automjet tip “Citroen DS3”**, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për moskualifikimin si burim të ligjshëm të gjendjes *cash* që subjekti ka pasur në fund të vitit 2013, me të cilën është paguar kësti i parë për blerjen e këtij automjeti në datën 03.01.2014, në shumën 10.000 euro. Subjekti i rivlerësimit pretendon se më datë 25.10.2013 ka tërhequr nga llogaria bankare në “Credins Bank” shumën 915.000 lekë, të cilën e ka mbajtur *cash* deri më datë 31.12.2013. Mosdeklarimin e kësaj gjendje *cash* në deklaratën periodike të vitit 2013, subjekti e konsideron si pakujdesi, që nuk shuan ekzistencën e saj.

6.9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit nuk ka përmbushur kriteret kryesore të imponuara nga ligjvënësi dhe praktika e Gjykatës Kushtetuese mbi nevojën e arsytimit të vendimit, i cili duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Argumentet e pjesës arsytuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht duke formuar një përmbajtje koherente brenda vendimit.

6.10. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit karakterizohet nga një kontradiksion i dukshëm në vlerësimin dhe nxjerrjen e konkluzioneve për marrjen apo jo në konsideratë të gjendjes *cash*, në kontekstin e situatave dhe rrethanave identike. Subjekti ka sjellë si argument analizimin e pasurisë tjetër të saj, automjetin “Citroen C5”, të trajtuar në pikën 4 të vendimit të Komisionit, ku për të njëjtat fakte dhe situata ligjore Komisioni ka konkluduar se kjo pasaktësi nuk ndikonte në vlerësimin e subjektit dhe ka njohur përdorimin e gjendjes *cash*, sipas pretendimit të saj.

IV. Shqyrtimi i çështjes në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit

A. *Procesi gjyqësor dhe aspektet procedurale të gjykimit*

i) *Juridiksioni i Kolegjit dhe legjitimimi i ankuesit*

7. Në zbatim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenit F, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion *ratione materiae* të shqyrtojë ankimet kundër vendimeve të Komisionit, që në këtë rast ka vendosur shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit. Ankuesi

⁵ Vendimet nr. 242, datë 28.02.2020 dhe nr. 311, datë 21.10.2020, të Komisionit.

⁶ Vendimet nr. 34, datë 20.12.2005, nr. 39, datë 14.10.2007, nr. 4, datë 12.02.2010 dhe nr. 48, datë 15.11.2013, të Gjykatës Kushtetuese.

legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, duke qenë subjekt rivlerësimi.

Ankimi i subjektit të rivlerësimit është depozituar pranë Komisionit më datë 08.04.2021, ndërsa data e dorëzimit të njoftimit të vendimit të subjektit të rivlerësimit është më 26.03.2021, sipas lajmërim-marrjes së shërbimit postar.

Për rrjedhojë, ankuesja legjitimohet edhe *ratione temporis*, pasi ka ushtruar të drejtën e ankimit ndaj vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.

ii) *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

8. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, i nënshtrohet parashikimit të nenit 49 “Gjykimi në apel administrativ në dhomë këshillimi” të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, i cili përcakton shqyrtimin e ankimit në bazë të dokumenteve në dhomën e këshillimit.
9. Aktet⁷ bashkëlidhur ankimit, trupi gjykues i vlerësoi në raport me parashikimet ligjore që normojnë trajtimin e provës së re në gjykimin administrativ në shkallë të dytë, referuar nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, i cili parashikon: “Në ankim nuk mund të paraqiten fakte të reja dhe të kërkohen prova të reja, përveçse kur ankuesi provon se pa fajin e tij nuk ka mundur t’i paraqesë këto fakte ose t’i kërkojë këto prova në shqyrtimin e çështjes në gjykatën administrative të shkallës së parë, në afatet e parashikuara në këtë ligj”, si edhe nenit 49, pika 6 e ligjit nr. 84/2016.

9.1. Lidhur me vërtetimet e lëshuara nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë, me qëllim vërtetimin e të ardhurave të motrës dhe babait të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues vëren se janë akte të cilat janë administruar edhe gjatë hetimit administrativ në Komision dhe referojnë fakte të njohura nga Komisioni. Për këto arsye, trupi gjykues vlerësoi se këto akte duhet të përjashtohen nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre provuese në zgjidhjen e çështjes dhe të refuzohet të merren si prova, bazuar edhe në nenin 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016⁸.

9.2. Lidhur me dokumentin “Informacion” të agjencisë imobiliare “{***}”, përgatitur nga z. A. D., me objekt “Informacion rreth vlerave të tregut të qirave për vilat në zonën rreth pasurisë nr. {***}, z. k. {***}, Tiranë, për vitet 1993 -1998”, trupi gjykues konstaton se në prapësimet e paraqitura në Komision më datë 12.02.2021, mbi rezultatet e hetimit administrativ, bashkëlidhur tyre, subjekti i rivlerësimit ka depozituar aktin “Raport vlerësimi”, përgatitur nga

⁷ Bashkëlidhur ankimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur aktet: (1) Redaktimi i procesverbalit për bërje inventari të noteres Dh. Xh. Q., me nr. {***}, rep., nr. {***} kol., datë 06.04.2021, në të cilin gjenden të përfshirë komunikimi me e-mail me Komisionin dhe ekstrakte të njësuara të: (a) vërtetim nr. {***}, datë 09.12.2020, i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë, për të ardhurat e motrës N. D.; (b) vërtetim nr. {***}, datë 09.12.2020, i Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë, për të ardhurat e babait S. D.. (2) Informacioni konfidencial i Agjencisë së parë të tregut imobilar të pasurive të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë, “{***}”, përgatitur nga A. D. datë 14.01.2021.

⁸ Neni 49, pika 6, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: “[...] 6. Kërkesa për marrjen e një prove refuzohet nga Komisioni ose Kolegji i Apelit, nëse nuk lejohet nga ligji ose në rastet kur: [...] b) fakti që kërkohet të provohet është i parëndësishëm për vendimmarrjen ose mund të rezultojë i provuar gjatë gjykimit [...]”.

ing. A. Sh., për të njëjtën pasuri. Në kushtet kur fakti që kërkohet të provohet, rezulton i evidentuar edhe gjatë hetimit në Komision, si dhe nga ana e subjektit të rivlerësimit nuk është paraqitur ndonjë argument apo arsye për pamundësinë e paraqitjes së këtij akti gjatë hetimit administrativ në Komision, trupi gjykues vlerëson se ky akt nuk mund të pranohet në cilësinë e provës, në këtë fazë të procesit, në kuptim të parashikimit të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012, por të dhënat e pasqyruara në të do të jenë në vëmendje të trupit gjykues, duke qenë se janë përfshirë si pjesë integrale e vetë ankimit.

9.3. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni ka anashkaluar aktet dhe provat e administruara, duke mos i përdorur ato në përlllogaritjen financiare, për nxjerrjen e konkluzioneve finale, trupi gjykues, duke konstatuar se ato janë analizuar prej Komisionit, çmon se fakti që këto akte e prova të subjektit Komisioni nuk i ka vlerësuar në mënyrën e dëshiruar prej saj, nuk mund të barazohet me mungesën e vlerësimit e analizës lidhur me to, në kuptim të garantimit të elementeve të procesit të rregullt ligjor.

9.4. Pavarësisht se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur pretendime për shkelje procedurale të kryera nga Komisioni, trupi gjykues kontrolloi procedurën e zhvillimit të procesit të saj të rivlerësimit, si dhe vlerësoi dokumentacionin e fashikullit të administruar gjatë hetimit administrativ në Komision dhe nuk konstatoi të jenë kryer shkelje procedurale, të tilla që të kërkojnë korrigjimin e tyre, sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerësoi se duhet të vijojë me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit mbi bazën e dokumentacionit që gjendet në fashikullin e krijuar nga Komisioni, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar.

B. Analizimi i shkaqeve të ankimit

10. Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe 113 m², ndodhur në rrugën “{*}”, Tiranë**

10.1. Komisioni ka konstatuar se subjekti nuk ka paraqitur në mënyrë të saktë dhe të plotë burimin e krijimit të kësaj pasurie në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe në deklaratën periodike të vitit 2003, pasi gjatë hetimit administrativ ka deklaruar si burim për pagesën e dy kësteve të para për këtë pasuri *me hua nga motra*, në një kohë që në deklaratën *vetting* dhe në deklaratën periodike vjetore është deklaruar vetëm *kredi bankare*. Komisioni, nisur nga fakti se nuk rezulton të jetë deklaruar huaja e marrë në vitin 2003, shlyerja e saj po në këtë vit, detyrimi i mbetur apo shlyerjet e pretenduara përgjatë viteve 2003 – 2008, vlerësoi se deklarimi i kësaj huaje vetëm gjatë hetimit administrativ është një burim i ri krijimi për pasurinë dhe vendosi që të mos e marrë atë në konsideratë, si burim krijimi për këtë pasuri.

Lidhur me pagesën e këstit të parë për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 113 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, në vlerën prej 10.000 USD paguar në datën 10.10.2002, pas kryerjes së analizës financiare, Komisionit i rezultoi se subjekti nuk kishte pasur mundësi financiare në shumën prej 994.722 lekësh për të paguar këtë këst, si dhe për të përballuar shpenzimet familjare.

Lidhur me pagesën e këstit të dytë, paguar në datën 15.02.2003 në vlerën 7.000 USD, pas kryerjes së analizës financiare, Komisionit i rezultoi se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare në shumën prej 683.116 lekësh për të paguar këtë këst, si dhe për të përballuar shpenzimet familjare.

Komisioni ka konstatuar, gjithashtu, pas analizës së kryer për familjen e subjektit të rivlerësimit se motra e saj N. D. dhe anëtarët e familjes nuk kanë pasur mundësi t'i jepnin hua subjektit të rivlerësimit shumën e pretenduar prej 2.000.000 lekësh, si rrjedhojë subjekti rezultoi të jetë në pamundësi financiare në shumën prej 1.677.838 lekësh, për të paguar dy këstet e para të kësaj pasurie, si dhe të përballojë shpenzimet familjare.

Në përfundim, Komisioni krijoi bindjen se pasaktësitë në deklaratimet e subjektit të rivlerësimit e bëjnë në këtë rast deklarinimin e saj të pamjaftueshëm, në kuptim të parashikimeve të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

10.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se mosdeklarimi në deklaratën *vetting*, por edhe në DPV-në 2003, i shumës prej 2.000.000 lekësh dhënë hua nga motra e saj në vitin 2002 është një pakujdesi e paqëllimtë e mospasjes së asnjë lloj dyshimi mbi ligjshmërinë e burimit, si dhe duke e konsideruar atë si një ndihmë dhe shfaqje e solidaritetit familjar. Sipas subjektit, kredia e marrë në ish-Bankën Amerikane në vitin 2003 përbënte burimin e vetëm për blerjen e apartamentit, pasi nëpërmjet shumës së kredituar ka likuiduar motrën dhe shoqërinë sipërmarrëse për pjesën e mbetur të papaguar të çmimit.

10.2/a. Sipas subjektit, shuma prej 2.000.000 lekësh përbën një burim të ligjshëm, pasi motra e saj e ka përfituar këtë shumë nga parapagimi i çmimit të shitjes të pasurisë truall, nëpërmjet kontratës së shitblerjes nr. {***}, datë 15.09.2003. Gjithashtu, subjekti pretendon se Komisioni në mënyrë flagrante nuk ka përfshirë në analizë të ardhurat nga puna/pensioni i babait të saj në vlerën 836.440 lekë, duke mos marrë në konsideratë provën e dorëzuar në Komision prej saj për të ardhurat e babait S. D., vërtetimin nr. {***}, datë 09.12.2020, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë.

10.2/b. Subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të pretendimeve të saj, ka depozituar në Komision deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.09.2020, të motrës së saj, në të cilën konfirmohet se shumata e dhëna subjektit të rivlerësimit për blerjen e apartamentit objekt kontrolli janë përkatësisht: në muajin tetor 2002 shuma 10.000 USD dhe në fillim të muajit shkurt 2003 shuma 7.000 USD, si dhe ka shpjeguar burimin e këtyre të ardhurave.

10.2/c. Subjekti i rivlerësimit, në përfundim të shpjegimeve të saj mbi këtë pasuri, pasi paraqet në formë tabelare analizën financiare⁹ për të ardhurat dhe shpenzimet e familjes së saj të origjinës (nëna, babai, motra dhe vëllai), për periudhën 1991-2003, pretendon se familja e saj ka pasur gjendje shumën prej 2.285.790 lekësh, duke provuar në këtë mënyrë se shuma e dhënë prej tyre për pagesën e dy kësteve të para në vlerën 17.000 USD është krijuar me të ardhura të ligjshme familjare.

⁹ Në faqen nr.10 të ankimit të subjektit.

10.3. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ndodhur në fashikujt e Komisionit, lidhur me këtë pasuri, rezulton se:

10.3/a. Agjencia Shtetërore e Kadastrës (në vijim AShK), Drejtoria Vendore Tirana Rurale 1, me shkresën nr. {***} prot., datë 04.06.2020, i ka përcjellë Komisionit dokumentacionin përkatës, nga ku rezulton se në emër të shtetasve Mariana S. Shegani dhe I. S. Sh. figuron e regjistruar pasuria nr. {***}, z. k. {***}, vol. {***}, f. {***} dhe sipas kartelës së pasurisë, pasuria apartament është me sipërfaqe 112,22 m². Bashkëlidhur kësaj shkrese ndodhet kontrata e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2019, me palë shitëse shoqërinë “{***}” ShPK dhe palë blerëse Mariana dhe I. Shegani.

Lidhur me pagesat e kryera për këtë pasuri, trupi gjykues vëren se:

10.3/b. Me kontratën e sipërmarrjes, datë 31.10.2002, lidhur midis shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK dhe porositësve Mariana Dedi dhe I. Sh., sipërmarrësi ka marrë përsipër të ndërtojë një apartament në katin e shtatë, të përbërë nga dy dhoma, një guzhinë, si dhe ambiente të tjera ndihmëse me një sipërfaqe 113 m², në godinën me 11 kate, ndodhur në rrugën “{***}”, kulla {***}, {***}, Tiranë, kundrejt çmimit 50.820 USD. Në nenin 4 të kësaj kontrate “*Afati dhe mënyra e pagesës*” janë përcaktuar modalitetet e pagesës, sipas së cilave:

- kësti i parë prej 15.000 USD paguhet me nënshkrimin e kontratës;
- kësti i dytë prej 10.000 USD paguhet brenda muajit nëntor 2002; dhe
- kësti i tretë prej 25.820 USD paguhet brenda muajit mars 2003 me kredi nga banka direkt në numrin e llogarisë së shoqërisë.

10.3/c. Me anë të kontratës së shitjes së pasurisë së paluajtshme nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2019, pala shitëse shoqëria me përgjegjësi të kufizuar “{***}” ShPK, përfaqësuar me prokurë në këtë kontratë nga znj. J. B. i ka shitur palës blerëse znj. Mariana Shegani dhe z. I. Sh. pasurinë e paluajtshme e llojit apartament të ndodhur në zonën kadastrale nr. {***}, nr. pasurie {***}, të regjistruar në vol. {***}, f. {***}, me sipërfaqe 112,22 m². Sipas nenit 2 të kësaj kontrate, vlera e apartamentit, ashtu si dhe në kontratën e sipërmarrjes, është përcaktuar në shumën totale prej 50.820 USD, vlerë të cilën shitësi deklaroi se pala blerëse e ka likuiduar totalisht nëpërmjet disa këste pagesash të derdhura në arkën dhe llogarinë bankare të shoqërisë sipas:

- mandatarkëtimit nr. {***}, datë 10.10.2002, shuma 10.000 USD;
- mandatarkëtimit nr. {***}, datë 15.2.2003, shuma 7.000 USD;
- mandatarkëtimit nr. {***}, datë 03.10.2003, shuma 6.000 USD;
- transfertës bankare të datës 07.12.2004, në ish-Bankën Amerikane të Shqipërisë (sot “Intesa Sanpaolo Bank”), shumën 24.500 USD të përfituara nga shoqëria “{***}” ShPK.

10.4. Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, trupi gjykues analizoi deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësoi përputhshmërinë e tyre në raport me dokumentacionin e administruar, duke konstatuar se:

10.4/a. Në deklaratën *vetting*, rezulton se për këtë pasuri subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament me sip. 113 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, sipas kontratës së sipërmarrjes nr. {***} rep., datë 31.10.2002. Kontrata e kredisë bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë*

25.07.2003. Blerë me kredi”. Vlera me shifra dhe me fjalë 50.820 USD (pesëdhjetëmijë e tetëqind e njëzet dollar). Pjesa: 50 %.

10.4/b. Në deklarinimin fillestar në DPV-në 2003, në formularin A-1, në rubrikën “Pasuri të paluajtshme dhe të drejta reale mbi to”, lidhur me pasurinë e sipërcituar, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një apartament banimi me sip. 113 m², në vlerën 52.000 USD, pjesa takuese 50 %, me burim kredi bankare për strehim. Në të njëjtën deklaratë, në formularin A-8, në rubrikën “Detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” rezulton se subjekti ka deklaruar kredinë në Bankën Amerikane të Shqipërisë në vlerën 52.000 USD, duke specifikuar dhe arsyen e krijimit të këtij detyrimi për strehim.

10.4/c. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 20.10.2020, subjekti i rivlerësimit ka rikonfirmuar se si burim krijimi i kësaj pasurie është kredia bankare, sipas kontratës me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.07.2003, duke konfirmuar planin e pagesave të cituar në kontratën e shitjes, si dhe ka depozituar mandatarkëtimet e sipërcituara.

10.4/d. Në dosje ndodhet kontrata e kredisë bankare nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 25.07.2003, me palë kredidhënëse Banka Amerikane e Shqipërisë dhe palë kredimarrëse I. Sh. e bashkëkredimarrëse Mariana Shegani të shumës 52.000 USD, për blerjen e një apartamenti të ri. Me shkresën nr. {***} prot., datë 19.05.2020, Intesa Sanpaolo Bank (ish-Banka Amerikane), ka informuar Komisionin¹⁰ mbi ekzistencën e kësaj kredie, e cila referuar këtij dokumenti është disbursuar në tri këste si më poshtë:

- më datë 06.08.2003 është disbursuar shuma 17.500 USD;
- më datë 07.12.2004 është disbursuar shuma 24.500 USD;
- më datë 06.12.2006 është disbursuar shuma 10.000 USD.

10.4/dh. Sikurse konstatohet më lart, likuidimi i shoqërisë sipërmarrëse “{***}” ShPK, për pagesën e dy kësteve të para për pasurinë objekt shqyrtimi, është kryer në muajin tetor të vitit 2002 dhe muajin shkurt të vitit 2003, ndërsa kredia e deklaruar si burim për krijimin e kësaj pasurie është disbursuar fillimisht në muajin gusht të vitit 2003 dhe pjesa tjetër në vitin 2004 dhe vitin 2006. Lidhur me këtë mospërputhje të momentit të disbursimit të kredisë me atë të pagimit të dy kësteve të para, në të njëjtin pyetësor, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se për pagesat në shumën 17.000 USD, sipas mandatarkëtimeve datë 10.10.2002 dhe datë 15.02.2003, është ndihmuar nga motra e saj me huan prej 2.000.000 lekësh dhe që këtë hua e ka shlyer pasi ka marrë kredinë.

10.4/e. Në mbështetje të këtij fakti, subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur në përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.09.2020, të motrës së saj, në të cilën, për sa i përket huas në shumën 2.000.000 lekë, përveç konfirmimit të huas, deklaruesja shprehet se në fillim të muajit tetor 2002 i ka dhënë motrës shumën prej 10.000 USD dhe, për shkak se nuk dispononte akoma shumën nga kredia bankare, në fillim të muajit shkurt 2003 i ka dhënë edhe shumën prej 7.000 USD, për të mbuluar pagesat e dy kësteve të apartamentit.

¹⁰ Protokolluar në Komision me shkresën nr. {***} prot., datë 29.05.2020.

10.4/f. Lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave (shumës prej 10.000 USD + 7.000 USD dhënë motrës së saj), në të njëjtën deklaratë noteriale, znj. N. D., deklaroi se *shumën 2.000.000 lekë e ka përfituar nga shitja e një pasurie truall, bazuar në kontratën e shitblerjes nr. {***}, datë 15.09.2003, shumë të cilën e ka marrë si parapagim nga blerësi që në shtator 2002, por për arsye që lidheshin me probleme personale kontratën e kanë formalizuar pas një viti. Si burim krijimi kanë shërbyer edhe kursime të tjera të krijuara më të ardhurat familjare (ku bëja pjesë unë dhe prindërit e mi) nga puna që kryeja që prej vitit 1980 në Fabrikën e Bukës Tiranë, Fabrika e Miellit Tiranë (ku zotëroj dhe një numër të vogël aksionesh), të ardhurat e prindërve nga pensionet e tyre, kontribute nga vëllai im, z. N. D., nga puna e tij në emigracion në Itali, si dhe interesat bankare të akumuluar, ndër vite, nga shumat e depozituara në Bankën e Kursimeve (sot "Raiffeisen Bank") në emrin tim dhe të babait S. D. [...]. Bashkëlidhur deklaratës noteriale znj. N. D. ka vendosur dokumentet provuese të thënieve të saj¹¹.*

10.4/g. Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, datë 25.11.2020, konkretisht në përgjigje të pyetjes nr. 2, mbi mënyrën dhe kohën se kur është shlyer detyrimi (huaja) që kishte ndaj motrës, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se ka kthyer shumën 2.000.000 lekë në harkun kohor të viteve 2003-2008. Shumën prej 6.000 USD e ka kthyer më datë 19.11.2003 dhe diferencën e ka kthyer në shuma të ndryshme deri në vitin 2008. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit deklaroi se nuk disponon dokumentacion për likuidimin e këtyre shumave ndër vite.

10.5. Nga analizimi i akteve të mësipërme, fillimisht trupi gjykues konstatoi se vetëm gjatë hetimit administrativ subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim për pagesën e dy kësteve të para për këtë pasuri *me hua nga motra*, në një kohë që në deklaratën *vetting* dhe në DPV-në 2003 është deklaruar vetëm *kredi bankare*.

Në këto kushte, trupi gjykues vlerëson se subjekti nuk ka deklaruar në mënyrë të saktë dhe të plotë burimin e krijimit të kësaj pasurie, si dhe nuk ka deklaruar huan e marrë nga motra dhe as shlyerjen e saj përgjatë viteve 2003 – 2008, në deklaratat periodike përgjatë viteve.

10.5/a. Lidhur me pretendimin e subjektit se mosdeklarimi i ndihmës së dhënë nga motra në deklaratën periodike të vitit 2003 është një pakujdesi e paqëllimshme, trupi gjykues e konsideron jobindëse në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk e ka deklaruar këtë hua si burim krijimi të pasurisë, jo vetëm në deklaratën fillestare të pasurisë, por as në deklaratën *vetting*, por e ka evidentuar atë si të tillë, vetëm në përgjigjet e dhëna në pyetësorin nr. 2, kur është pyetur nga Komisioni.

10.5/b. Subjekti i rivlerësimit, megjithëse ka pasur cilësinë e subjektit deklarues që në vitin 2003, sipas ligjit nr. 9049/2003 dhe, në kundërshtim me detyrimet e tij¹², në kuadër të procesit të rivlerësimit e deklaroi këtë hua 18 vite pas marrjes së saj, në mungesë të provave të kohës

¹¹ Kontratë shitblerje nr. {***}, datë 15.09.2003, vërtetim pronësie, datë 19.10.1998, për pasurinë truall, në Tiranë (objekt shitblerje në kontratën në fjalë), kërkesë për informacion dhe pajisje me dokument drejtuar "Raiffeisen Bank", mbi depozitat dhe qarkullimin monetar në emrin e N. D. dhe S. D..

¹² Referuar nenin 4, shkronja "dh" e ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, parashikohet se: "4. Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave brenda datës 31 mars të çdo viti, gjenden deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të interesave privatë, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: dh) detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë, të shprehura në lekë ose në valutë të huaj; [...]".

në të cilën është dhënë kjo shumë, mbetet një deklaram i cili nuk mund të verifikohet e që nuk krijon besueshmëri për ekzistencën e saj.

10.5/c. Gjithashtu, për pretendimin e subjektit të rivlerësimit se mosdeklarimi në deklaratën *vetting* është harresë, për shkak të kohës së hershme të marrjes së shumës nga motra dhe likuidimit totalisht të saj në datën e përpilimit të deklaratës *vetting*, trupi gjykues vlerëson se nuk vjen në përputhje me parashikimet e pikave 2 dhe 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës¹³ për detyrimet që kanë subjektet e rivlerësimit në plotësimin e deklaratës së rivlerësimit të pasurisë, si dhe udhëzimin nr. {***} prot., datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së “Për mënyrën e deklaramit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj., nga subjektet e rivlerësimit dhe personat e lidhur që mbartin detyrim për deklaram të pasurisë, në zbatim të ligjit nr. 84/2016, datë 30.08.2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Trupi gjykues sjell në vëmendje qëndrimin e Kolegjit se deklarimet për burimet e krijimit të pasurive, duhet të gjejnë pasqyrim në përputhje me ligjin, në deklaratën *vetting* dhe ato periodike, përndryshe subjektet vihen në kushtet e pamundësisë për të vërtetuar me deklarime të mëpasshme ekzistencën e tyre, në funksion të procesit të rivlerësimit.

10.6. Komisioni, pavarësisht qëndrimin të mbajtur lidhur me mosdeklarimin e kësaj huaje si burim, e ka vlerësuar atë edhe nën kontekstin e pretenduar nga subjekti, si një pakujdesi pa pasur qëllim dhe motiv për ta fshehur dhe për të krijuar bindjen analizoi çdo provë¹⁴ të depozituar nga subjekti, lidhur me të ardhurat e motrës dhe familjarëve të subjektit që pretendohen se kanë ndihmuar atë, në shlyerjen e dy kësteve të para në shumën prej 17.000 USD. Pas kryerjes së analizës financiare, Komisioni arriti në konkluzionin se motra e subjektit N. D. dhe anëtarët e familjes së saj nuk kanë pasur mundësi t’i jepnin hua subjektit të rivlerësimit shumën e pretenduar prej 2.000.000 lekësh.

10.7. Me qëllim shqyrtimin e pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim se si burim krijimi për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 113 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, ka shërbyer edhe huaja e marrë në vitin 2002 në shumën prej 2.000.000 lekësh nga motra e saj, trupi gjykues çmoi të ndalej në analizimin e dy elementeve të ndërthurur me njëri-tjetrin, konkretisht:

a) verifikimin e mundësisë financiare të motrës së subjektit të rivlerësimit, znj. N. D., me cilësinë e personit tjetër të lidhur, sipas parashikimit të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për të justifikuar me burime të ligjshme shumën prej 2.000.000 lekësh të dhënë hua dhe njëkohësisht; dhe

¹³ Subjekti i rivlerësimit dorëzon një deklaratë të re dhe të detajuar të pasurisë në përputhje me ligjin. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave kontrollon deklaratën e pasurisë dhe i dorëzon Komisionit një raport për ligjshmërinë e pasurive, për saktësinë dhe plotësinë e deklarimit, sipas ligjit. 3. Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllimet e këtij ligji konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore. Elemente të tjera të pasurisë së ligjshme përcaktohen me ligj.

¹⁴ Vërtetim të Institutit të Sigurimeve Shoqërore për të ardhurat nga pagat dhe pensionet për familjarët e subjektit. Deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} ko.l, datë 05.12.2020, të vëllait të saj, z. N. D., ku ky i fundit deklaronte se i ka dhënë motrës së tij, znj. N. D., shumën prej 1.900.000 lekësh, të cilën e dispononte nga të ardhurat e përfituara nga emigracioni.

b) verifikimin e ekzistencës së marrëdhënies së huas lidhur mes subjektit e motrës së saj, në kuadër të rrethanave që vetë subjekti i rivlerësimit ka prezantuar në proces.

10.7/a. Për këtë qëllim, trupi gjykues mori në analizë fillimisht mënyrën e përfitimit të të ardhurave nga motra e subjektit, znj. N. D.. Në kushtet ku subjekti i rivlerësimit pretendon se shumën prej 2.000.000 lekësh motra e saj e ka përfituar nga parapagimi i çmimit të shitjes së pasurisë truall, nëpërmjet kontratës së shitblerjes datë 15.09.2003, trupit gjykues, pasi verifikoi kontratën e shitjes së truallit nr. {***}, datë 15.09.2003, i rezultoi se pala shitëse N. D. (motra e subjektit) i ka shitur palës blerëse S. H., pasurinë truall me sipërfaqe 250 m², kundrejt shumës 2.000.000 lekë.

10.7/b. Trupi gjykues konstaton se kontrata e shitblerjes është lidhur më datë 15.09.2003, ndërkohë nga subjekti i rivlerësimit pretendohet se huaja e dhënë nga motra i përket fillimit të muajit tetor të vitit 2002 (shuma prej 10.000 USD) dhe në fillim të muajit shkurt 2003 (shuma prej 7.000 USD). Sikurse vërehet, huaja e përfituar nga subjekti është dhënë nga motra e saj N. D. disa muaj përpara se kjo e fundit të lidhte kontratën e shitblerjes së pasurisë truall dhe të përfitonte shumën të cilën pretendohet se ia ka dhënë hua subjektit të rivlerësimit.

10.7/c. Lidhur me këtë kontradiktë, subjekti i rivlerësimit pretendon se përfitimi i çmimit të shitjes, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***}, datë 15.09.2003, në shumën 2.000.000 lekë, është kryer nëpërmjet formës së parapagimit e përcaktuar kjo edhe në kontratën e shitjes. Sipas subjektit parapagimi është një veprim që dëshmon ekzistencën e marrëdhënies juridike paraprake, megjithëse Kodi Civil nuk i parashikon shprehimisht këto marrëdhënie, ato nuk janë në kundërshtim me ligjin, pasi normat e parashikuara në Kodin Civil kanë karakter lejues.

10.7/d. Nga analizimi i akteve të çështjes, trupi gjykues konstaton se në kontratën e shitblerjes nr. {***}, datë 15.09.2003, është cituar se [...] *shuma është likuiduar plotësisht para përpilimit të kontratës jashtë zyrës noteriale [...]*, në mbështetje të këtij fakti, subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.09.2020, të motrës së saj, znj. N. D., e cila deklaron se [...] *shumën 2.000.000 lekë, e kam përfituar nga shitja e një pasurie truall bazuar në kontratën e shitblerjes nr. {***}, datë 15.09.2003. Sqaroj se këtë shumë e kisha marrë si parapagim nga blerësi që në shtator 2002, por për arsye që lidheshin më probleme personale tona kontratën e formalizuar pas një viti [...]*.

10.7/dh. Pretendimi i subjektit për përfitim të shumës së motrës së saj nga shitja e truallit, disa muaj përpara përpilimit të kontratës së shitblerjes, nuk mbështetet në ndonjë provë, por vetëm në deklaratimet noteriale të motrës së subjektit gjatë procesit të rivlerësimit, për vlerën e të cilave Kolegji tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar¹⁵. Kjo paqartësi dhe mungesë deklarimi në

¹⁵ Vendimet e Kolegjit: nr. 6/2018(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Besa Nikëhasani; nr. 7/2019, që i përket subjektit të rivlerësimit Elision Sadiku; nr. 34/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti; nr. 2/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Besnik Cani; nr. 23/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Donika Prele; nr. 24/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Ferdinad Elezi; nr. 29/2020(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Edison Ademi; nr. 33/2020 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Dritan Seci; nr. 11/2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Përparim Kulluri; nr. 12/2021(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit Artan Madani; dhe nr. 11/2022(JR), që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Elizabeta Imeraj.

deklaratën periodike fillestare dhe e pashoqëruar me akte shkresore provuese të kohës i krijon vështirësi organeve të rivlerësimit për të konkluduar rreth kohës (muajin/datën) kur janë përfituar realisht të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie.

10.7/e. Huaja e pretenduar e marrë nga motra e saj në shumën 2.000.000 lekë, e cila, sipas saj, ka shërbyer për kryerjen e dy pagesave të para, të cilat së bashku janë në shumën prej 17.000 USD, për blerjen e pasurisë apartament me sipërfaqe 113 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, është deklaruar për herë të parë vetëm gjatë hetimit administrativ. Kjo hua nuk është deklaruar nga subjekti në DPV-në 2003 dhe as në deklaratën *vetting*; nuk janë deklaruar shlyerjet e saj përgjatë viteve 2003 – 2008, ashtu siç subjekti ka pretenduar dhe shpjeguar gjatë hetimit administrativ në Komision; nuk ka specifikuar shumën që i ka kthyer motrës në secilin vit; si dhe nuk ka asnjë gjurmë të kohës për huan e marrë, por as për shlyerjen e saj me anë të kredisë sipas pretendimeve.

10.7/f. Për sa më lart, bazuar në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit mbi vlerën provuese të deklaratave të interesave privatë ndër vite¹⁶, si dhe në kushtet kur huaja e pretenduar e përfituar nuk është deklaruar asnjëherë, bazuar në nenin 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vlerëson se Komisioni me të drejtë nuk e ka përfshirë këtë hua si burim krijimi të pasurisë në analizën financiare të kryer për subjektin e rivlerësimit.

10.8. Pavarësisht sa më sipër, në funksion të shqyrtimit të plotë të ankimit, trupi gjykues mori në analizë pretendimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit se motra e saj, znj. N. D., në përballimin e shumës së dhënë asaj, është ndihmuar nga të ardhurat e ligjshme familjare të siguruara nga puna dhe pensioni i anëtarëve të tjerë të familjes dhe konstatoi se Komisioni:

a) Të ardhurat nga pensioni i babait, z. S. D., në vlerën prej 836.440 lekësh nuk i ka marrë në konsideratë në funksion të përlllogaritjeve të kryera, pasi ka konstatuar se nuk janë të mbështetura në dokumentacion për të provuar këtë shumë.

b) Të ardhurat nga pensioni i nënës, znj. E. D., subjekti i ka deklaruar në vlerën 593.808 lekë dhe ka depozituar vërtetimin nr. {***} prot., datë 10.02.2021, nga ISSh-ja, prej të cilit, sipas përlllogaritjeve të Komisionit, rezultuan të ardhura nga pensioni për periudhën 01.01.1991 – shkurt 2003, në shumën 524.482 lekë.

c) Për të ardhurat e motrës, znj. N. D., subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga punësimi në shumën 852.217 lekë. Subjekti ka depozituar dokumentacion nga ISSh-ja, vërtetim për bazën e vlerësueshme dhe pagën neto mesatare, si dhe përlllogaritjet e kryera nga ky institucion për pensionin e përfituar, ku të dhënat për bazën e vlerësuar janë të indeksuara në vite për shkak të përlllogaritjeve të masës së pensionit. Nga përlllogaritjet e Komisionit, rezultoi se motra e subjektit ka realizuar të ardhura nga punësimi për periudhën 01.01.1991 – shkurt 2003, në shumën 868.171 lekë.

d) Për të ardhurat e vëllait, z. N. D., subjekti ka depozituar vërtetim nr. {***} prot., datë 09.02.2021, nga Ministria e Mbrojtjes, i cili pasqyron pagën referuese për vitet 1992 – 1995, në shumën 122.820 lekë, vërtetim nr. {***} prot., datë 11.02.2021, nga shoqëria “{***}”, sipas

¹⁶ Vendimet e Kolegjit nr. 6/2018, nr. 8/2018, nr. 9/2018, nr. 11/2018, nr. 12/2018, nr. 5/2019, nr. 19/2019, nr. 20/2019, nr. 5/2020, nr. 27/2020.

së cilit për vitet 1999 – shkurt 2003, vëllai i subjekti ka realizuar të ardhura nga punësimi, në vlerën 1.659.248 lekë.

Në total të ardhurat e realizuara nga familja, për vitet 1991 – shkurt 2003, sipas Komisionit kanë qenë në shumën 3.174.721 lekë.

dh) Lidhur me shpenzimet e jetesës, Komisioni i ka përlllogaritur ato në masën 66% e të ardhurave për vitet 1991-1999 dhe për vitet 2000-2003 sipas INSTAT-it¹⁷, duke mos përlllogaritur shpenzime jetese për vëllain e subjektit përgjatë viteve 1992 – 1997, pasi sikurse ka deklaruar subjekti ka qenë emigrant në shtetin italian. Gjithashtu, Komisioni, në analizën financiare të kryer për familjen e origjinës së subjektit, ka konsideruar edhe investimin e kryer nga motra e subjektit për blerjen e truallit në vitin 1998, në vlerën 1.500.000 lekë (truall i cili është shitur më pas në vitin 2003 në vlerën 2.000.000 lekë).

Në përfundim të analizës së kryer mbi këto të dhëna, Komisioni krijoi bindjen se motra e subjektit të rivlerësimit N. D. dhe anëtarët e familjes së saj nuk kanë pasur mundësi t'i jepnin hua subjektit të rivlerësimit shumën e pretenduar prej 2.000.000 lekësh.

10.8/a. Në lidhje me sa më lart, trupi gjykues, pasi shqyrtoi dokumentacionin e administruar, konstatoi se Komisioni në mënyrë të padrejtë nuk ka përfshirë në analizë të ardhurat nga puna/pensioni, i babait të saj, z. S. D.. Të ardhurat e përfituara nga pensioni¹⁸ i tij për periudhën 01.01.1987 - 30.10.2011, konfirmohen me anë të vërtetimit nr. {***}, datë 09.12.2020, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë. Rezulton se babai i subjektit të rivlerësimit, duke filluar nga viti 1991, ka përfituar 707.894 lekë nga pensioni i pleqërisë dhe 84.319 lekë shpërbllim si veteran. Për rrjedhojë, në kushtet kur një institucion shtetëror konfirmon masën e pensionit të z. S, D., pretendimi i subjektit të rivlerësimit gjendet i drejtë dhe këto të ardhura janë konsideruar në analizën e kryer në Kolegj.

10.8/b Trupi gjykues i Kolegjit nëpërmjet Njësisë së Shërbimit Ligjor (në vijim NjShL) përlllogariti të ardhurat e përfituara nga babai i subjektit të rivlerësimit dhe në të njëjtën kohë përlllogariti edhe shpenzimet e jetesës së tij, si pjesë përbërëse e shpenzimeve të jetesës së gjithë familjes për të njëjtën periudhë. Në ndryshim nga analiza financiare e kryer në Komision, NjShL-ja në Kolegj, referuar jurisprudencës së konsoliduar¹⁹, ka përlllogaritur në analizën financiare vetëm të ardhurat dhe shpenzimet e jetesës së familjes së origjinës së subjektit të rivlerësimit dhe pa përfshirë në këtë analizë shpenzimet e kryera për investime që dalin jashtë kategorisë së shpenzimeve të jetesës, në këtë rast janë përjashtuar shpenzimet e kryera për blerjen e pasurisë tokë truall në vitin 1998 dhe të shitur më pas në vitin 2003. Nga analiza financiare e kryer në Kolegj mbi këto korrigjime të analizës së Komisionit, rezultoi se familja e origjinës së subjektit të rivlerësimit kishte pasur mundësi financiare për të dhënë huan në vlerën 17.000 USD në kohën e pretenduar prej subjektit.

¹⁷ Shkresë nr. {***} prot., datë 04.03.2019, nga ILDKPKI-ja.

¹⁸ Në përgjigje të pyetësorit nr. 4, datë 25.11.2020, subjekti ka dorëzuar vërtetimin nr. {***}, datë 09.12.2020, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, Drejtoria Rajonale Tiranë, babai ka filluar të përfitojë të ardhura nga pensioni që nga viti 1987, por për shkak të periudhës së analizuar, të ardhurat janë përlllogaritur duke filluar nga viti 1991.

¹⁹ Vendimet nr. 15/2023 (JR), datë 13.04.2023 dhe nr. 2/2023 (JR), datë 02.02.2023.

10.9. Në përfundim, për pasurinë apartament banimi, me sipërfaqe 113 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi se pretendimi i subjektit të rivlerësimit se për likuidimin e dy pagesave të para të kësaj pasurie kishte shërbyer huaja e marrë nga motra e saj në vlerën 17.000 USD, fakt i padeklaruar në deklaratën *vetting* dhe as në DPV-në 2003, mbeti i paprovuar, referuar standardit ligjor e jurisprudencës së Kolegjit, pavarësisht faktit se nga kontrolli i analizës së Komisionit mbi konkluzionet e mësipërme të arritura nga trupi gjykues, rezulton se familja e origjinës kishte mundësi të huazonte shumën e pretenduar me burime të ligjshme.

Duke mos e njohur këtë shumë si burim për pagimin e këtyre kësteve, subjekti ka rezultuar me balancë negative në vlerën prej (-) 1.673.375 lekësh, për krijimin e kësaj pasurie për periudhën maj-tetor 2002 dhe janar-shkurt 2003, situatë e cila e vendos subjektin në kushtet e parashikuara prej nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

11. Lidhur me investimin e kryer nga subjekti i rivlerësimit në pasurinë apartament me sip. 45,5 m², në {*}, Kavajë**

11.1. Komisioni, pasi administroi provat e depozituara gjatë hetimit dhe deklaratimet e subjektit, vëren se si burim për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 45,5 m², në {***}, Kavajë, subjekti ka deklaruar të ardhurat nga paga dhe ndihma nga anëtarët e familjes. Lidhur me kontributin e familjarëve, ku, ndër të tjera, subjekti ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga dhënia me qira e pronës nga nëna e bashkëshortit, Komisioni konstatoi se mungonte dokumentacioni justifikues për përfitimin e të ardhurave nga qiraja, si dhe i shlyerjes së detyrimeve tatimore për këto të ardhura përgjatë viteve 1994 – 1998. Komisioni vlerësoi se të ardhurat nga qiraja nuk mund të merren në konsideratë si të ardhura të ligjshme në analizën financiare, pasi subjekti i rivlerësimit nuk përmbushi detyrimin ligjor, në kuptim të pikës 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, të provonte me dokumentacion ligjor përfitimin e të ardhurave nga qiraja nga prindërit (nëna) e bashkëshortit. Në këto kushte, subjekti rezultoi në pamundësi financiare në shumën (-) 1.354.372 lekë për të investuar në pasurinë apartament me sipërfaqe 45,5 m², në {***}, Kavajë.

11.2. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin e paraqitur në Kolegj, mban të njëjtin qëndrim ashtu si ka deklaruar edhe gjatë hetimit administrativ në Komision, lidhur me ndihmën e dhënë nga anëtarët e familjes për blerjen apartamentit me sipërfaqe 45,5 m², në {***}, Kavajë, duke shpjeguar se janë të ardhurat e përfituara nga qiraja e pasurisë në pronësi të nënës së bashkëshortit. Sipas subjektit, konkluzioni i Komisionit është nxjerrë duke anashkaluar parashikimet ligjore dhe provat²⁰ vendimtare në lidhje me burimin e krijimit të kësaj pasurie, pasi:

²⁰ - Deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.09.2020, të personit të lidhur V. Sh.. Sipas kësaj deklaratë, deklaruesja V. Sh. (nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit) ka deklaruar mbi pronësinë që zotëron, marrëdhënien e qirasë për vitet 1994-1998 dhe shumën e përfitur prej 2.000 USD/muaj nga kjo qiradhënie. Nga kjo shumë, ka deklaruar ajo, 500 USD/muaj ia jepja djalit, z. I. Sh., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit;

- certifikatë për vërtetim pronësie;

- kërkesë drejtuar subjektit gjerman {***} (ish-{***}) për informacion në lidhje me marrëdhënien e qirasë;

- i. provat e paraqitura në Komision vërtetojnë se nëna e bashkëshortit të saj, znj. V. Sh., e ka dhënë pronën e saj me qira në vitet 1994-1998, me çmim mujor 2000 USD/muaj, për llogari të subjektit gjerman {***} ({***});
- ii. të ardhurat nga qiraja janë përfituar në një periudhë të hershme kohore dhe, rrjedhimisht, personi tjetër i lidhur, nëna e bashkëshortit, nuk e ka ruajtur kontratën e qirasë dhe as pala qiramarrëse subjekti “{***}” nuk e ka mohuar zhvillimin e kësaj marrëdhënie qiraje, por shpreh pamundësinë e tij për të vënë në dispozicion dokumentacionin, për shkak të kalimit të afatit 10-vjeçar të ruajtjes;
- iii. ka shteruar të gjitha mundësitë ligjore për të provuar në mënyrë të plotë ekzistencën e kësaj marrëdhënie qiraje, duke zhvilluar komunikime me subjektin “{***}”, duke caktuar ekspertë të fushës për të provuar çmimin e qirasë në kohën kur është zhvilluar marrëdhënia;
- iv. ka ezauruar dhe garantuar çdo kërkesë ligjore, ka paguar dhe detyrimin tatimor, duke mos përjashtuar mundësinë që ky tatim mund të jetë paguar nga qiramarrësi në periudhën e qirasë.

11.2/a. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni e ka zhvlerësuar aktin e ekspertimit të ing. A. Sh. pa e shoqëruar me argumente logjike dhe analizë ligjore. Konstatimin e Komisionit se çmimi i vendosur prej vlerësuesit është për të gjithë sipërfaqen e ndërtesës, ndërkohë që subjekti dhe familja e saj kanë banuar po në këtë ndërtesë, ku kanë pasur në dispozicion ambientin prej një dhomë e një kuzhinë, subjekti i rivlerësimit e konsideron jorelevant, pasi, sipas saj, qiraja e objektit të dhënë me qira ka qenë 2000 USD, ndërsa vlerësuesi ka përcaktuar një vlerë më të lartë qiraje prej 2.452 USD, duke përfshirë të gjithë pronën dhe jo vetëm pjesën e dhënë me qira.

11.2/b. Raportin e vlerësimit për pasurinë e paluajtshme, të punuar nga ing. A. Sh., si dhe dokumenti “Informacion” i Agjencisë imobiliare “{***}”, përgatitur nga z. A. D., i paraqitur në Kolegj bashkë me ankimin, subjekti i rivlerësimit i konsideron si prova shkresore, në të cilat jepet mendim tekniko-shkencor mbi përcaktimin e çmimit të qirasë së pronës të personit tjetër të lidhur, nënës së bashkëshortit të saj, në kohën e dhënies me qira të pronës.

11.2/c. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në rast se tërësia e veprimeve dhe provave të sipërcituara do të analizoheshin në mënyrë harmonike me njëra-tjetrën do të arrihej në konkluzionin se provohet ligjshmëria e shumës prej 1.354.372 lekësh, që ka shërbyer si burim krijimi për pasurinë apartament në Kavajë.

11.3. Në kuadër të verifikimit të këtyre pretendimeve të subjektit dhe fakteve që kanë shërbyer për arritjen në konkluzionin e Komisionit se subjekti rezultoi në pamundësi financiare në

- përgjigjen e subjektit gjerman {***}, nëpërmjet së cilës, ky i fundit bën me dije se {***} nuk ruan dokumentacion financiar dhe logjistik për më shumë se 10 vjet në arkivat e tij, për individët e kontraktuar si ekspert;

- deklaratë e Dr. M. B., i cili deklaroi se ka punuar për {***} dhe se një prej kolegëve të tij ka qenë edhe eksperti z. F., i cili ka qëndruar te familja Sh.;

- deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.09.2020, të bashkëshortit z. I. Sh.. Sipas kësaj deklaratë, shtetasi I. Sh. (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), rikonfirmon deklaratën e nënës së tij në lidhje me dhënien me qira të banesës, një eksperti të ekonomisë të organizatës gjermane {***} gjatë viteve 1994-1998 dhe se ka përfituar 500 USD/muaj;

- aktvlerësimi të kryer nga eksperti vlerësues i pasurive të paluajtshme ing. A. Sh.;

- urdhërpagesë të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe mandatpagesë datë 10.02.2021 të “Credins Bank”, për pagesën e tatimit në burim në shumën 401.785 lekë, për të ardhurat e përfituara nga qiraja.

shumën prej 1.354.372 lekësh për të investuar në pasurinë apartament me sipërfaqe 45,5 m², në {***}, Kavajë, Kolegji mori në shqyrtim dhe vlerësoi një sërë rrethanash që rezultojnë të provuara lidhur me këtë çështje dhe arriti në një vlerësim të ndryshëm nga Komisioni për këtë pasuri.

11.3/a. Subjekti i rivlerësimit e deklaroi për herë të parë këtë pasuri në deklaratën periodike vjetore të vitit 2003, me përshkrimin: “*Apartament banimi mbas vitit 1990, 45,5 m², në {***}, Kavajë. Vlera: 2.600.000 lekë. Burimi: Blerë me kursime nga paga dhe ndihma nga anëtarët e familjes*”.

Në deklaratën periodike vjetore të vitit 2007, subjekti i rivlerësimit e deklaroi shitjen e tij me përshkrimin: “*Apartament me sipërfaqe 45,5m², {***}, Kavajë (kontrata e shitjes bashkangjitur). Vlera: 27.000 euro*”.

11.3/b. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Kavajë, me shkresën nr. {***} prot., datë 05.06.2020, ka informuar Komisionin se z. I. Sh. ka qenë pronar i pasurisë me nr. {***}, e llojit apartament me sip. 45,5 m², e përfituar me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.04.2002, midis shitësit A. Rr. dhe blerësit I. Sh.. Këtë pasuri z. I. Sh. ia ka shitur z. A. K., me kontratën e shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 23.04.2007, në vlerën 27.000 euro.

11.3/c. Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 20.10.2020, në lidhje me vlerën e kësaj pasurie, si dhe mbi burimin e krijimit të saj, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se: “*Vlera prej 2.600.000 lekësh e deklaruar në deklaratën periodike të vitit 2003, është një lapsus, pasi vlera e pasurisë është ajo e përcaktuar në kontratën e shitblerjes, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 02.04.2002, në shumën 3.600.000 lekë*”.

Lidhur me kontributin e familjarëve, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se ato janë 500 USD/muaj, në periudhën 1994 – 1998, në total në vlerën 24.000 USD, dhënë nga nëna e bashkëshortit të saj, e cila i ka përfituar nga dhënia me qira e pasurisë së saj në vlerën 2000 USD në muaj. Ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorëve, ka sqaruar se [...] *ndihma nga anëtarët e familjes, janë pagesa të kryera nga subjekti gjerman {***} ({***}), sot {***} ({***}) {***}, nënës së bashkëshortit. Pagesat janë kryer për ekspertin Mr. R. F., një nga ekspertët e Projektit të Legjislacionit Ekonomik në Shqipëri, pranë Ministrisë së Financave, për marrëdhënien e qirasë, në periudhën 1994–1998, nga 500 USD/muaj, në total 24.000 USD.*

11.4. Me qëllim verifikimin e ekzistencës së marrëdhënies së qirasë, të ardhurat e të cilës pretendohen nga subjekti se kanë shërbyer për krijimin e pasurisë apartament me sipërfaqe 45,5 m², në {***}, Kavajë, trupi gjykues mori në shqyrtim provat e depozituara nga subjekti i rivlerësimit lidhur me këtë pretendim, konkretisht:

- i) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.09.2020, e znj. V. Sh., (nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit), e cila ka deklaruar mbi pronësinë që zotëron, marrëdhënien e qirasë për vitet 1994-1998, shumën e përfituar prej 2.000 USD/muaj nga kjo qiradhënie, si dhe faktin se 500 USD/muaj ia jepte djalit të saj, z. I. Sh., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit;

- ii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.09.2020, e z. I. Sh., (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit), i cili rikonfirmon deklaratën e nënës së tij në lidhje me dhënien me qira të banesës, një eksperti të ekonomisë të organizatës gjermane {***} gjatë viteve 1994-1998, duke përfituar 500 USD/muaj;
- iii) kërkesë datë 18.05.2020, drejtuar subjektit gjerman {***} (ish-{***}), për informacion në lidhje me marrëdhënien e qirasë;
- iv) përgjigja datë 15.07.2020 e subjektit gjerman {***}, ku bën me dije se ai nuk ruan dokumentacion financiar dhe logjistik, për më shumë se 10 vjet në arkivat e tij, për individët e kontraktuar si ekspertë; si dhe
- v) deklaratë datë 27.08.2020, e Dr. M. B., i cili deklaron se ka punuar për {***} dhe se një prej kolegëve të tij ka qenë edhe eksperti z. F., i cili ka qëndruar te familja Sh..

11.5. Lidhur me aktet e sipërcituara, trupi gjykues vlerëson se ato tregojnë përpjekje serioze të subjektit të rivlerësimit për të vërtetuar me dokumentacion justifikues ligjor marrëdhënien e qirasë të nënës së bashkëshortit të saj me përfaqësues të subjektit gjerman {***}, në kushtet kur dokumenti *kontratë qiraje* nuk është ruajtur nga nëna e bashkëshortit të subjektit, edhe për shkak të mungesës së detyrimit ligjor dhe kohës së largët të ekzistencës së marrëdhënies së qirasë (viti 1994), si dhe ky dokument nuk mund të bëhej përsëri ose nuk mund të merrej në rrugë tjetër.

11.6. Subjekti ka depozituar në Komision raportin e vlerësimit, datë 12.02.2021, për pasurinë e paluajtshme *truall+ndërtesë, zona kadastrale {***}, nr. pasuri {***}, volumi {***}, faqe {***}, Tiranë, në pronësi të znj. V. Sh.* Sipas ekspertit, ing. A. Sh., vlera e tregut të qirasë mujore për këtë pasuri për periudhën 01.07.1994 - 31.12.1999, është 2452 USD. Lidhur me këtë akt vlerësimi, Komisioni ka mbajtur qëndrimin se *nuk konstaton në raport asnjë krahasim të pronës objekt vlerësimi me prona të ngjashme për të arritur në konkluzionin e vlerës së qirasë mujore prej 2.452 USD/muaj.*

11.6/a. Me qëllim kundërshtimin e konkluzionit të mësipërm të Komisionit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Kolegj bashkë me ankimin dokumentin “Informacion” i Agjencisë imobiliare “{***}”, agjenci e cila ka qenë ndërmjetësuese për dhënie me qira të vilave përreth zonës ku ndodhet edhe pasuria e nënës së bashkëshortit të subjektit. Në këtë dokument, përgatitur nga z. A. D., datë 14.01.2021, jepen të dhëna²¹ për çmimet e qirave të vilave që ndodhen pranë pronës së znj. V. Sh., për periudhën 1993-1998. Këtë informacion, subjekti i rivlerësimit e ka përfshirë edhe në ankim si argument për të kundërshtuar qëndrimin e

²¹ Sipas raportit konfidencial rezulton se: “[...] ju bëj me dije se pranë vilës, pronë e znj. Shëgani me vendndodhje, sikurse është ilustruar në planet grafike, vilë kjo e shtrire pranë Ambasadës Gjermane Spanjolle, Britanike, agjencia “{***}”, për periudhën 1993-1998 ka qenë ndërmjetësuese për dhënie me qira të vilave të shtrira “brenda rretheve me ngjyrë të gjelbër” e konkretisht:

1. Vilë 1-katëshe rreth 130 m² që në vitin 1993 ishte në pronësi të familjes M., e cila në pranverë të vitit 1993 u kontaktua me qira nga i ngarkuari me punë i Ambasadës Iraniane në Republikën e Shqipërisë si rezidencë e titullarit, për një periudhë 5-vjeçare. Qiraja mujore ishte 3.300 USD/muaj (tremijë e treqind dollar amerikan).

2. Vilë 2-katëshe rreth 129 m², në secilin kat, që në vitin 1993 ishte në pronësi të familjes S., e cila po në pranverë të vitit 1993 u kontraktua me qira nga i ngarkuari me punë i Ambasadës Iraniane në Republikën e Shqipërisë si Ambada e Republikës së Iranit, për një periudhë 5-vjeçare. Qiraja mujore ishte 4.300 USD/muaj (katër mijë e treqind dollar amerikan).

Komisionit se nuk ka të dhëna për krahasim të çmimit të dhënies me qira të pronës objekt vlerësimi me prona të tjera të ngjashme.

11.6/b. Lidhur me raportet e vlerësimit të sipërcituara dhe të dhënave të tyre të pasqyruara edhe në ankim, trupi gjykues konstaton se ato përfaqësojnë mendime tekniko-shkencore mbi përcaktimin e çmimit të qirasë së pronës të personit të lidhur, nënës së bashkëshortit të subjektit, në periudhën kur pretendohet dhënia e saj me qira. Këto raporte të karakterit teknik, pavarësisht se nuk mund të përbëjnë dokumentacion provues për ekzistencën e marrëdhënies së qirasë, mund të shërbejnë si indicie, për përcaktimin e një shume hipotetike/të mundshme të vlerës së qirasë për këtë pronë. Gjithashtu, në funksion të një analize për vlerësimin e besueshmërisë së deklarimeve të subjektit, vërehet se këto raporte nëpërmjet të dhënave të mbështetura në referenca konkrete, krijojnë besueshmëri se në atë zonë shtëpitë e dhëna me qira ishin minimalisht në vlerën e deklaruar nga subjekti madje edhe më të larta.

11.7. Sipas vlerësimit të trupit gjykues, nga aktet e administruara e të përmendura më lart, krijohet besueshmëria mbi ekzistencën e marrëdhënies së qirasë për pasurinë e nënës së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për periudhën 1994-1998, ndërsa rezulton e paprovuar sasia e të ardhurave të pretenduara se janë krijuar prej saj, si edhe pagimi në kohë i detyrimeve tatimore lidhur me to, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, të ardhura të cilat kanë shërbyer për krijimin e pasurisë së blerë në vitin 2002 dhe shitur në vitin 2007.

Në vlerësimin e kësaj situatë faktike, nën dritën e kuadrit ligjor të kohës, shihet e vlefshme të përmenden disa konstatime rreth kohës së zhvillimit të këtij aktiviteti, duke i konsideruar në tërësinë e rrethanave të faktit që lidhen me këtë moment.

11.8. Duke konsideruar faktin se të ardhurat nga qiraja nuk i përkasin drejtpërdrejtë subjektit të rivlerësimit, por familjes së bashkëshortit të saj²², si dhe faktin se këta të fundit (familja e bashkëshortit) dhe vetë subjekti i rivlerësimit nuk kanë pasur në këto vite detyrimin për deklarime të pasurisë dhe as vëmendje të posaçme për të pasqyruar me saktësi momentin e krijimit të pasurisë, burimet e krijimit apo ruajtjen e dokumentacionit vërtetues, përfshi të ardhurat që subjektit dhe bashkëshortit i ishin dhënë/dhuruar nga nëna e këtij të fundit, në kushtet e një marrëdhënie të posaçme, trupi gjykues vlerëson se deklarimi i burimit të krijimit të pasurisë objekt shqyrtimi, në deklaratën fillestare të vitit 2003 *ndihma nga anëtarët e familjes*, duke qenë një deklaram i kohës në një akt që përbën provë, sipas nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, përfaqëson një tregues që krijon besueshmëri mbi ekzistencën e kësaj të ardhure, si burim krijimi i pasurisë nën kontroll.

11.9. Subjekti pretendon se referuar në nenet 7 dhe 8 të ligjit nr. 7786, datë 27.01.1994, “Për të ardhurat personale”, megjithëse detyrimi për pagesën e detyrimit tatimor i takon subjektit gjerman “{***}” (duke mos përjashtuar faktin që ky detyrim të jetë paguar nga “{***}” në periudhën kur ka ekzistuar marrëdhënia e qirasë) në datën 11.02.2021, ka kryer pagesën e

²² Në ndryshim nga situata në të cilën është ndodhur ish-subjekti i rivlerësimit Fatos Qato, i gjykuar me vendimin nr. 29, datë 08.11.2019, të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i cili nuk kishte deklaruar të ardhurat e krijuara nga kjo marrëdhënie si burim krijimi të pasurisë së tij, as në deklaratën vetting dhe as në deklaratën fillestare të pasurisë 2003, ndërsa përfituesit e këtyre të ardhurave ishin persona të lidhur me këtë ish-subjekt për shkak të jetesës së përbashkët/gjendjes familjare të përbashkët.

tatimit në burim në vlerën 401.785 lekë, për vlerën totale të të ardhurave nga qiraja të pretenduara se janë përfituar prej saj. Për rrjedhojë, subjekti pretendon se shuma e pretenduar, si e përfituar prej saj (24.000 USD) gjatë viteve 1994 – 1998, nga të ardhurat e përfituara nga marrëdhënia e qirasë së nënës së bashkëshortit të saj, duhet të konsiderohet e ligjshme.

11.9/a. Subjekti i rivlerësimit Mariana Shegani ka dorëzuar në Komision dokumentin “*Formulari i deklaramentit dhe pagesës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat*”, në të cilin në rubrikën “*Llojet e pagesave për të cilat mbahet tatimi në burim*”, në pjesën “*Pagesat për qiranë*” është përcaktuar shuma 2.608.577 lekë dhe tatimi në burim është në vlerën 401.785 lekë. Bashkëlidhur gjendet dhe mandatpagesa, datë 11.02.2021, e kryer nga znj. Mariana Shegani në “Credins Bank”, me përshkrimin *tatim i mbajtur në burim*, shuma 401.785 lekë.

11.10. Trupi gjykues, pavarësisht mungesës së kontratës së qirasë në një formë shkresore, vlerëson se përpjekjet e subjektit të rivlerësimit për plotësimin e kërkesave të ligjit për ligjshmërinë e të ardhurës, nëpërmjet pagesës së detyrimit tatimor për qiranë e pretenduar të përfituar nga nëna e bashkëshortit të saj, ndonëse është kryer gjatë procesit të saj të rivlerësimit (datë 11.02.2021), është një element që duhet të konsiderohet në drejtim të sjelljes së subjektit në raport me ligjshmërinë e këtyre të ardhurave, të cilat nuk janë krijuar drejtpërdrejtë prej saj. Trupi gjykues vlerëson të rëndësishme të sjellë në vëmendje se ndonëse pagimi i detyrimit tatimor nuk mund të shërbejë si një mjet për legjitimitetin e të ardhurave në kohën e krijimit të tyre, në mungesë të dokumentacionit ligjor të kohës, në këndvështrim të faktit se ky detyrim i përkiste personave të tjerë, nga të cilët është përfituar e ardhura dhe peshës që ky element ka në vlerësimin e ligjshmërisë së të ardhurës, do të konsiderojë këtë rrethanë në vlerësimin me objektivitet të burimeve të përdorua për blerjen e pasurisë objekt kontrolli.

11.11. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se Komisioni ka mbajtur një praktikë kontradiktore, në analizimin dhe vendimmarrjen e çështjeve të ngjashme²³, duke cenuar haptazi

²³ Subjekti referon në vendimin nr. 311, datë 21.10.2020, të Komisionit duke cituar pjesë të tij: “[...] Në Aneksin e Kushtetutës nuk përcaktohet se kur duhet të jenë paguar detyrimet tatimore për t’i konsideruar të ardhurat e ligjshme. Gjithashtu, edhe në dispozitat e Legjislacionit Tatimor nuk ka asnjë pengesë për kohën e pagimit të detyrimeve tatimore, e cila në rast vonesash shoqërohet me penalitet, që është gjoha dhe kamatëvonesa. Në rastin objekt gjykimi, detyrimi i personit të lidhur është paguar përpara vendimmarrjes nga Komisioni nga vetë subjekti, pavarësisht se nuk ishte detyrim i tij personal. Ky tatim është paguar menjëherë sapo subjekti është vënë në dijeni të faktit, nëpërmjet pyetësorëve të bërë nga Komisioni [...]”, si dhe vendimin nr. 242, datë 28.02.2020, të Komisioni nga i cili citon: “[...] Në këto kushte, Komisioni vlerëson se personat e tjerë të lidhur gjenden për arsye të ekzistencës së disa rrethanave që e vendosin subjektin e rivlerësimit në kushtet e pikës 2, të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: “[...] Nëse subjekti i rivlerësimit është në pamundësi objektive për të disponuar dokumentin që justifikon ligjshmërinë e krijimit të pasurive, duhet t’i vërtetojë institucionit të rivlerësimit se dokumenti është zhdukur, ka humbur, nuk mund të bëhet përsëri ose nuk merret në rrugë tjetër. Institucionet e rivlerësimit vendosin nëse mosparaqitja e dokumenteve justifikuese është për shkaqe të arsyeshme [...], për shkak se: (i) fakti që në kohën e krijimit të këtyre të ardhurave, personat e tjerë të lidhur, A. dhe H.V., prindërit e subjektit, nuk e gëzonin statusin e personave të tjerë të lidhur të subjektit të rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016, dhe nuk kishin ndonjë detyrim ligjor të tregoheshin të kujdesshëm deri në nivelin e ruajtjes së dokumentacionit që provon ligjshmërinë e të ardhurave të tyre në atë kohë, përveç se, për sa ata kanë çmuar të nevojshme sipas kujdesit të çdo qytetari normal; (ii) koha e largët në të cilën janë krijuar këto të ardhura e bën të vështirë edhe vetë ruajtjen e dokumentacionit që mund të sillte edhe më tepër informacion në këtë drejtim, edhe për shkak të një logjike normale ligjore që duket se nuk merr përsipër të ruajë apo arkivojë dokumente të kësaj natyre për një periudhë kaq të gjatë kohe, madje as nga vetë institucionet shtetërore”.

parimin kushtetues të barazisë para ligjit, trupi gjykues sqaron se çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuara nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Kolegji, brenda juridiksionit dhe kompetencës së tij kushtetuese, shqyrton ankimin e paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, vetëm për shkaqet e pretenduara prej tij, të cilat lidhen me vendimin e Komisionit objekt ankimi dhe jo me konkluzionet e arritura nga Komisioni në vendime të tjera për subjekte të tjera rivlerësi.

11.12. Trupi gjykues i Kolegjit, pasi kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni, në ndryshim nga ky i fundit, i cili për periudhën 1992-1999 ka përllogaritur shpenzimet e jetesës për familjen e subjektit në masën 66% të të ardhurave, i përllogariti ato referuar jurisprudencës së Kolegjit²⁴ në masën 30% të të ardhurave, e dhënë që ka ulur ndjeshëm balancën negative të analizës financiare lidhur me mundësinë e subjektit për të justifikuar me burime të ligjshme blerjen e kësaj pasurie në vitin 2002.

Nga analiza financiare e kryer në Kolegji, pas ndryshimit të vlerës së shpenzimeve të jetesës si më lart, balanca negative për krijimin e kësaj pasurie rezultoi në vlerën prej (-) 447.298 lekësh. Këtë balancë, trupi gjykues e vlerësoi në raport me rrethanat faktike të rastit, e që lidheshin me vlerësimin e burimit *ndihmë nga anëtarët e familjes*, të deklaruar për këtë pasuri nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën fillestare të vitit 2003, e cila buron nga të ardhurat prej marrëdhënies së qirasë që deklarohet se ka pasur familja e bashkëshortit të subjektit për një pasuri (vilë) në pronësi të saj, në periudhën 1994 -1998, të cilat nuk janë njohur si të ardhura të ligjshme për subjektin e rivlerësimit.

11.13. Trupi gjykues, në analizë të rrethanave që kanë rezultuar nga dokumentacioni i administruar, vëren se evidentohen të dhëna që ndikojnë në një nivel të konsiderueshëm besueshmërie të marrëdhënies së qirasë për pasurinë vilë, në pronësi të vjehrrës së subjektit, për periudhën 1994 -1998. Në këtë mënyrë vërtetimi i pronësisë datë 24 mars 1998, sipas së cilit në regjistrin hipotekor nr. {***} figuron e regjistruar në pronësi të V. Sh., një shtëpi dykatëshe e përbërë nga kati i parë dy dhoma e kuzhinë + aneks, banjë e sallon, si dhe kati i dytë i përbërë nga dy dhoma e sallon, ndërtuar mbi një truall me sipërfaqe 500 m², ndodhur në rrugën “{***}”, janë tregues se kjo pasuri me të tilla përmasa dhe strukturë, e ndodhur në një zonë mjaft të preferuar të qytetit të Tiranës, mund të jepej lehtësisht me qira, duke marrë në konsideratë nevojat e popullsisë të asaj periudhe për shfrytëzimin e pasurive dhe nxjerrjen e përfitimeve nga dhënia me qira e tyre. Këto të dhëna trupi gjykues i vlerëson edhe në raport me deklaratimet koherente dhe konsistente të subjektit të rivlerësimit, duke filluar nga deklarimi në DPV-në 2003, ashtu edhe në shpjegimet e dhëna gjatë hetimit administrativ në Komision për ekzistencën e marrëdhënies së qirasë dhe përfitimin e shumave nga vjehrra e saj, nga të cilat 24.000 USD i janë dhënë/dhuruar familjes së subjektit në formë ndihme.

²⁴ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 15, datë 18.06.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit Kastriot Selita, paragrafi 21.41.

11.13/a. Ky konstatim gjen mbështetje në dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ në Komision konkretisht në: deklaratën noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.09.2020, e znj. V. Sh. (nëna e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit), e cila ka deklaruar mbi pronësinë që zotëron, marrëdhënien e qirasë për vitet 1994-1998 me një ekspert të ekonomisë të organizatës gjermane {***}, shumën e përfituar prej 2.000 USD/muaj, si dhe faktin se nga kjo qiradhënie 500 USD/muaj ia jepte djalit z. I. Sh., bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit; kërkesën e datës 18.05.2020, drejtuar subjektit gjerman {***} (ish-{***}), për informacion në lidhje me marrëdhënien e qirasë; deklaratën datë 27.08.2020, e Dr. M. B., i cili deklaron se ka punuar për {***} dhe se një prej kolegëve të tij ka qenë edhe eksperti z. F., i cili ka qëndruar te familja Sh.; raportin e vlerësimit, datë 12.02.2021, të ing. A. Sh., mbi përcaktimin e vlerave të tregut të qirasë mujore për këtë pasuri për periudhën 01.07.1994 - 31.12.1999; si dhe dokumentin “*Formulari i deklarimit dhe pagesës së tatimit të mbajtur në burim mbi të ardhurat*”, bashkëlidhur mandatpagesa e datës 11.02.2021, e kryer nga znj. Mariana Shegani, në “Credins Bank”, me përshkrimin *tatim i mbajtur në burim*, në shumën 401.785 lekë.

11.14. Duke konsideruar elementët si më poshtë: (i) besueshmërinë e ekzistencën së kontratës së qirasë për pasurinë e vjehrrës së saj në vitet e cituara më sipër; (ii) deklarin si burim të të ardhurave të familjes në deklaratën fillestare të pasurisë; (iii) vlerat e larta të mundshme të qirasë që referohen nga ekspertë të fushës pas analizës së tregut në kohën e ekzistencës së marrëdhënies dhe të dhënave të pasurisë në fjalë; (iv) fakti që këto të ardhura janë përfituar prej prindërve të bashkëshortit të subjektit dhe jo prej asaj vetë e përjashton përgjegjësinë e drejtpërdrejtë të subjektit për mosdokumentimin e marrëdhënies apo përfitimit të të ardhurave, si edhe pagimin e detyrimeve tatimore për to, krahas kohës së largët dhe informalitetit të saj; (v) komunikimet e vazhdueshme të subjektit të rivlerësimit me përfaqësues të organizatës gjermane {***} (ish-{***}), me qëllim gjetjen e dokumentacionit justifikues ligjor për provueshmërinë e marrëdhënies së qirasë, përgjigjen e përfaqësuesit të kësaj organizate Dr. M. B., rreth qëndrimit të ekspertit z. F. te familja Sh.; (vi) përpjekjet e subjektit për legjitimimin e të ardhurës nëpërmjet pagimit të detyrimeve tatimore gjatë procesit, në kushtet e kur ajo nuk ishte përgjegjësjë për pagimin e tyre; (vii) balanca negative e mbetur për krijimin e kësaj pasurie është në vlera të ulta krahasuar me shumën e pretenduar prej subjektit, si të përfituar prej prindërve të bashkëshortit me burim qiranë, e cila pretendohet në vlerën prej 24.000 USD dhe pagimi i detyrimeve tatimore për të gjithë këtë vlerë, e çon trupin gjykues në konkluzionin se kjo balancë nuk duhet të konsiderohet si përcaktuese në vlerësimin e kësaj pasurie, por në vlerësimin e të gjithë situatës ajo vlerësohet se nuk cenon standardin kushtetues të parashikuar nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës se *subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave* dhe, si pasojë, ajo nuk gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

11.15. Për rrjedhojë, në analizë të sa është shtjelluar më sipër, trupi gjykues arriti në konkluzionin se subjekti ka një nivel të besueshëm në provimin e burimeve të ligjshme për pasurinë apartament me sipërfaqe 45,5 m², në {***}, Kavajë.

12. Lidhur me pasurinë automjet tip “Citroen DS3”, blerë në vitin 2014, në vlerën 18.000 euro

12.1. Komisioni ka konstatuar se për këstin e parë të paguar për blerjen e këtij automjeti, në datën 03.01.2014, në shumën 10.000 euro ose 1.401.000 lekë, subjekti është në pamundësi financiare për krijimin e të gjithë shumës së paguar, pasi nuk rezulton që në deklaratën periodike të vitit 2013 të ketë deklaruar kursime *cash* apo të ketë kryer ndonjë tërheqje nga llogaritë bankare përpara likuidimit të kësaj shume.

12.1/a. Komisioni ka vlerësuar se shuma e tërhequr në datën 25.10.2013 në vlerën prej 915.000 lekësh nuk mund të merret në konsideratë, për faktin se, jo vetëm që nuk korrespondon me këstin e paguar, por edhe se data e tërheqjes me datën e përdorimit të saj pasqyrojnë një periudhë kohore relativisht të largët. Komisionit, pasi vendosi të mos e përfshijë gjendjen *cash* të pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si burim për pagesën e këstit të parë, i rezultoi se ajo kishte pamundësi financiare në shumën 966.243 lekë, për blerjen e automjetit tip “Citroen Ds3”, duke u gjendur në kushtet e germës “b”, të pikës 5, të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

12.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit për moskualifikimin si burim të ligjshëm të gjendjes *cash* që ajo ka pasur në fund të vitit 2013, pasi më datë 25.10.2013 ka tërhequr nga llogaria bankare në “Credins Bank”, shumën 915.000 lekë, të cilën pretendon se e ka mbajtur *cash* më datë 31.12.2013. Mosdeklarimin e kësaj gjendje *cash* në deklaratën periodike të vitit 2013, subjekti e konsideron si pakujdesi, që nuk shuan ekzistencën e saj.

12.2/a. Subjekti i rivlerësimit pretendon se faktin që shumën 915.000 lekë e ka pasur *cash* të papërdorur, provohet dhe nga deklarata periodike vjetore e vitit 2013, në të cilën janë deklaruar të gjitha shpenzimet e kryera gjatë vitit 2013, ku, sipas saj, nuk rezulton ta ketë përdorur këtë likuiditet për të krijuar ndonjë pasuri tjetër apo për të përballuar ndonjë shpenzim tjetër.

12.2/b. Subjekti i rivlerësimit pretendon se në trajtimin e pasurisë automjet tip “Citroen DS3”, vendimi i Komisionit nuk ka përmbushur kriteret kryesore të imponuar nga ligjvënësi dhe praktika e Gjykatës Kushtetuese mbi nevojën e arsyetimit të vendimit, i cili duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Subjekti pretendon se argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht duke formuar një përmbajtje koherente brenda vendimit.

12.2/c. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit karakterizohet nga një kontradiksion i dukshëm në vlerësimin dhe nxjerrjen e konkluzioneve për marrjen apo jo në konsideratë të gjendjes *cash*, në kontekstin e situatave dhe rrethanave identike, duke sjellë si argument analizimin e pasurisë tjetër të saj, automjetin “Citroen C5”, të trajtuar në pikën 4 të vendimit të Komisionit, ku, sipas saj, për të njëjtat fakte dhe situata ligjore, Komisioni ka konkluduar se kjo pasaktësi nuk ndikonte në vlerësimin e subjektit.

12.3. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, duke marrë në analizë pretendimet e subjektit të rivlerësimit, vlerësuar këto në raport me aktet e administruara në fashikullin e Komisionit dhe arsyetimin e këtij të fundit në vendim, trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me këtë pasuri, konstaton si më poshtë.

12.3/a Subjekti i rivlerësimit në deklaratën e *vetting*, në rubrikën “Përshkrimi i pasurisë dhe burimi i krijimit”, ka deklaruar: “Automjet Citroen DS3, kontratë shitje, datë 03.01.2014. Certifikata e pronësisë së mjetit rrugor {***}, datë 07.01.2014. Blerë me të ardhurat nga shitja e makinës tip Benz, {***} dhe Citroen C2, si dhe të ardhurat nga paga. Vlera: 18.000 euro. Pjesa në zotërim: 50%”.

12.3/b Në deklaratën e interesave periodike të vitit 2014, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “Kontratë blerje autoveturë Citroen DS3 So Chic 1.6 e-HDi MCP STT. Kontratë shitje datë 03 janar 2014. Vlera: 18.000 euro”.

12.3/c Nga dokumentacioni i ndodhur në dosjen e ILDKPKI-së, rezulton se znj. Mariana Shegani, me kontratë shitje automjeti, datë 03.01.2014, ka blerë nga shoqëria “{**}” ShPK, automjetin e markës “Citroen”, tipi DS3 me çmimin prej 18.000 eurosh me TVSH. Gjithashtu, në dosje gjendet edhe certifikata e pronësisë së mjetit rrugor {***}, targë {***} lëshuar, datë 07.01.2014, në pronësi të Mariana Sheganit.

12.3/d Referuar dokumentacionit mbështetës²⁵ të dorëzuar nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, datë 20.10.2020, mbi likuidimin e pasurisë së luajtshme automjet tip “Citroen DS3”, rezulton se kjo pasuri është likuiduar me tri këste si më poshtë:

- kësti i parë, datë 03.01.2014, në shumën 10.000 euro;
- kësti i dytë, datë 11.02.2014, në shumën 4.000 euro;
- kësti i tretë, datë 25.04.2014, në shumën 4.000 euro.

12.3/dh. Nisur nga fakti se për burimin e krijimit të pasurisë automjet tip “Citroen DS3”, subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting* deklaroi se kanë shërbyer si burim të ardhurat nga shitja e automjetit tip Benz, me targë {***} dhe automjetit “Citroen C2”, si dhe të ardhurat nga paga, trupi gjykues mori në shqyrtim fillimisht dokumentacionin përkatës të këtyre dy automjeteve, nga ku rezultoi se:

a) Me kontratën e shitjes, datë 07.10.2011, personi i lidhur I. Sh. ka shitur automjetin e markës “Mercedes-Benz”, në vlerën 2.800 euro. Këto të ardhura të përfituara nga shitja e automjetit të markës “Mercedes-Benz” nuk janë deklaruar në deklaratën e interesave periodike të vitit 2011, gjithashtu, nuk rezulton të ketë deklaruar gjendje *cash* apo mbartje të kësaj shume deri në vitin 2014, vit në të cilin është investuar për pasurinë tjetër automjet tip “Citroen DS3”. Për rrjedhojë, trupi gjykues në Kolegj, ashtu si dhe Komisioni, ka vlerësuar se kjo e ardhur nuk mund të merret në konsideratë si burim për krijimin e kësaj pasurie, për aq kohë sa subjekti nuk e ka deklaruar atë si gjendje *cash* në deklaratën periodike të vitit 2011 ose në çdo mënyrë si një gjendje e mbartur deri në momentin e investimit në këtë pasuri.

²⁵ Vërtetim datë 21.10.2020 të shoqërisë “{***}” ShPK, faturë tatimore shitje me nr. serie {***}, nr. {***}, datë 03.01.2014, në vlerën 18.000 euro (konvertuar në 2.521.980 lekë), Ditar Klienti, Ekstraktin e “Raiffeisen Bank”, për “{***}” ShPK, ku identifikohen pagesat e kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj.

b) Me faturë tatimore shitje nr. {***} ,datë 30.01.2007, rezulton se Mariana Shegani ka blerë nga “{***}” ShPK, automjetin tip “Citroen C2”, në vlerën 13.000 euro ose ekuivalenti 1.626.300 lekë me TVSH. Këtë automjet, subjekti i rivlerësimit, me kontratën e shitblerjes së datës 23.01.2014, ia ka shitur vëllait të saj N. D. në vlerën 5.500 euro. Nga verifikimi rezulton se të ardhurat e përfituara nga shitja e pasurisë “Citroen C2”, në vlerën 5.500 euro në datën 23.01.2014, përkojnë me periudhën e pagesës së këstit të dytë të çmimit të automjetit, paguar nga subjekti i rivlerësimit më datë 11.02.2014, në vlerën 4.000 euro, për rrjedhojë, trupi gjykues, ashtu si dhe Komisioni, ka vlerësuar se kjo e ardhur mund të ketë shërbyer si burim vetëm për pagesën e këstit të dytë .

12.4. Lidhur me burimin tjetër të krijimit të pasurisë automjet tip “Citroen DS3”, “*të ardhurat nga paga*”, deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting* nga subjekti i rivlerësimit, në kushtet kur Komisioni nuk e ka konsideruar si një burim të mundshëm në analizën e tij financiare shumë 915.300 lekë, të tërhequr nga subjekti në bankë më datë 25.10.2013, trupi gjykues i Kolegjit verifikoi gjendjet e llogarisë, shumat e tërhequra, si dhe mori në analizë veprimet bankare të kryera nga subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj 25 tetor-31 dhjetor 2013 nga ku rezultoi se:

a) Subjekti i rivlerësimit më datë 25.10.2013 ka tërhequr nga llogaria e saj e pagës, në “Credins Bank”, vlerën 915.300 lekë. Bashkëshorti i subjektit ka tërhequr nga llogaria e tij e pagës, në “Intesa Sanpaolo Bank”, për periudhën 25 tetor -31 dhjetor 2013, vlerën 795.000 lekë²⁶.

Nga data 25 tetor deri më 31 dhjetor 2013, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj kanë tërhequr në total nga llogaria e pagës së tyre vlerën 1.710.300 lekë. Rezulton se gjatë kësaj periudhe bashkëshorti i subjektit ka depozituar në llogarinë e kredisë dy vlera nga 480 USD (total 960 USD konvertuar në 97.786 lekë²⁷), për likuidimin e këstit të kredisë për muajin nëntor- dhjetor 2013.

b) Shpenzimet e jetesës për periudhën 25 tetor - 31 dhjetor 2013 janë përlllogaritur në vlerën 96.670 lekë.

c) Subjekti i rivlerësimit ose personat e lidhur nuk kanë kryer ndonjë investim gjatë kësaj periudhe, si rrjedhojë subjekti ka pasur mundësi të kursente deri më datë 31.12.2013, vlerën 915.300 lekë, të tërhequr në datën 25.10.2013.

12.5. Trupi gjykues vëren se në deklaratën periodike/vjetore të vitit 2013 nuk është deklaruar shuma 915.300 lekë si gjendje likuiditet në *cash*, si edhe nuk është deklaruar nga subjekti në deklaratën periodike/vjetore as përdorim apo pakësim i kësaj gjendjeje si detyrim që kishte bazuar në nenin 4 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003²⁸.

12.6. Lidhur me këtë fakt, si dhe në funksion të analizimit të pretendimit të subjektit të rivlerësimit *se vendimi i Komisionit karakterizohet nga një kontradiksion në vlerësimin dhe*

²⁶ 75.000 lekë nga data 25 tetor deri në 31 tetor, 375.000 lekë gjatë muajit nëntor dhe 345.000 lekë gjatë muajit dhjetor.

²⁷ Konvertuar me kursin e Bankës Shqipërisë, datë 31.12.2013, k. K. 101.86.

²⁸ Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, në nenin 4 parashikonte: “Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë [...] gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë: [...] d) vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe në huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj [...]”.

nxjerrjen e konkluzioneve për marrjen apo jo në konsideratë të gjendjes cash, ku, sipas saj, për të njëjtat fakte dhe situata ligjore, Komisioni për pasurinë tjetër të saj, automjetin “Citroen C5”, ka konkluduar se kjo pasaktësi nuk ndikonte në vlerësimin e subjektit, trupi gjykues mori në analizë vendimin e Komisionit, lidhur me pasurinë automjet tip “Citroen C5”, trajtuar në pikën 4 të vendimit të Komisionit, nga ku rezultoi se:

12.6/a. Me kontratë shitblerje, faturë nr. {***}, datë 05.05.2011, pala shitëse bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. I. Sh., ka blerë nga shoqëria “{***}” ShPK automjetin tip “Citroen C5” me targa {***}, me çmim 31.500 euro me TVSH, likuiduar në tri këste konkretisht: kësti i parë, datë 27.10.2011, në shumën 18.700 euro; kësti i dytë, datë 30.12.2011, në shumën 5.000 euro; dhe kësti i tretë, datë 17.01.2012, në shumën 7.800 euro.

12.6/b. Pas kryerjes së analizës financiare, Komisionit i rezultoi se subjekti kishte pasur mundësi të investonte për dy këstet e para të kësaj pasurie (kësti i parë, datë 27.10.2011, në shumën 18.700 euro dhe kësti i dytë, datë 30.12.2011, në shumën 5.000 euro), si dhe të përballonte shpenzimet e tjera familjare.

12.6/c. Për këstin e fundit, paguar në datën 17.01.2012, në shumën 7.800 euro, gjatë hetimit administrativ në Komision, rezultoi se bashkëshorti i subjektit kishte tërhequr nga llogaria e tij bankare në “Intesa Sanpaolo Bank”, shumën 1.000.000 lekë, datë **02.11.2011**, të cilën subjekti nuk e kishte deklaruar si gjendje *cash* në fund të vitit 2011, por pretendoi se kishte shërbyer për pagesën e këstit të fundit më datë **17.01.2012**. Pas shpjegimeve të dhëna nga subjekti, pas kalimit të barrës së provës, Komisioni²⁹ arriti në përfundimin se [...] *Trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti në prapësime, vlerëson se mosdeklarimi i shumës 1.000.000 lekë, si gjendje cash në fund të vitit 2011, të tërhequr nga “Intesa Sanpaolo Bank” nga ana e bashkëshortit të saj, mbetet një pasaktësi në deklarim*³⁰. [...] *Nën këto argumente faktike, për sa më sipër, trupi gjykues konkludon se kjo pasaktësi nuk ndikon në vlerësimin tërësor të subjektit të rivlerësimit në këtë vendimmarrje [...].*

12.6/d. Ndërsa në arsyetimin e tij për pasurinë objekt shqyrtimi në Kolegj, automjetin tip “Citroen DS3”, Komisioni lidhur me gjendjen *cash* mban qëndrim të ndryshëm, ndonëse në rrethana pothuaj të njëjta, duke arsyetuar³¹ se [...] *Pretendimi i subjektit se ka pasur gjendje cash në fund të vitit 2013 dhe me të ka paguar këstin e parë prej 10.000 euro të kësaj pasurie, nuk mund të merret në konsideratë, për faktin se ndryshe nga dy tërheqjet e tjera, në fund të vitit, të arsyetuara në këtë vendim për pasurinë nr. {***} dhe pasurinë nr. {***}, në këtë rast shuma e tërhequr në datën 25.10.2013, jo vetëm që nuk korrespondon me këstin e paguar, por,*

²⁹ Pika 4.10 e vendimit të Komisionit fq. 22.

³⁰ Komisioni pasqyron si arsye se:

Rezulton që kjo shumë është një tërheqje e vetme dhe jo si rezultat i disa tërheqjeve brenda vitit kalendarik.

Burimi i krijimit të shumës së tërhequr është i ligjshëm dhe i akumuluar nga pagat.

Nga analiza financiare ka rezultuar se viti 2011 është mbyllur me një balancë pozitive.

Nga data e tërheqjes së shumës deri në datën e pagesës së këstit të fundit të automjetit, nuk rezultoi që subjekti apo familjarët të kishin kryer ndonjë investim tjetër.

Shuma e tërhequr është përdorur brenda një afati kohor të shkurtër dhe përpara dorëzimit të deklaratës periodike vjetore, çka krijon bindjen se pasaktësia e deklaratimit lidhet me mos disponimin e kësaj shume përpara dorëzimit të deklaratës periodike.

³¹ Paragrafi 5.12, faqe 22 e Komisionit.

edhe se data e tërheqjes me datën e përdorimit të saj relativisht pasqyrojnë një periudhë kohore të largët. Subjekti pretendon se ka pasur jo vetëm shumën prej 915.000 lekësh të tërhequr nga llogaria e saj bankare, por edhe shuma të tjera nga të ardhurat nga pagat e vitit 2013 të bashkëshortit, por pa e cilësuar saktësisht se sa mund të ketë qenë kjo gjendje [...].

12.6/dh. Lidhur me sa më lart nga krahasimi i qëndrimeve të mbajtura nga Komisioni, përkatësisht për dy pasuritë automjet tip “Citroen DS3” dhe automjet “Citroen C5”, trupi gjykues vëren se rrethanat dhe situatat e paraqitura për këto dy pasuri, mbi deklarin e gjendjes *cash*, përdorimin e saj dhe situatën financiare të subjektit, janë pothuajse të njëjta ndërsa konkluzioni i Komisionit për marrjen në konsideratë të gjendjes *cash* të padeklaruar është i ndryshëm.

12.6/e. Konkretisht, argumenti i paraqitur nga Komisioni në vendim, për pasurinë e luajtshme automjet tip “Citroen DS3” se nga dita e tërheqjes së shumës deri në përdorimin e saj është një periudhë relativisht e gjatë, është në kontradiktë me arsyetimin e bërë dhe faktet e paraqitura nga vetë Komisioni në vendim. Sikurse rezulton për pasurinë automjet “Citroen DS3” diferenca ditore nga data e tërheqjes bankare (25.10.2013) deri në datën 03.01.2014 (e pagesës së këstit) është 70 ditë, ndërsa për pasurinë tjetër automjet “Citroen C5”, diferenca ditore nga data e tërheqjes bankare (02.11.2011) deri në datën 17.01.2012 (e pagesës së këstit) është 75 ditë.

12.7. Nga sa më lart konstatuar, trupi gjykues vlerëson se qëndrimi i Komisionit, për gjendjen *cash* të padeklaruar në deklaratat periodike vjetore, ka qenë jo koherent në trajtimin dhe analizimin e situatave për dy pasuritë e sipërcituara në të njëjtin vendim.

12.8. Në analizë të ligjshmërisë të shumës prej 915.000 lekësh, në përgjigje të shkakut të ankimit të subjektit të rivlerësimit, në raport me deklarin e saj të interesave në vite, si dhe me situatën faktike të pasqyruar më lart për këtë çështje, trupi gjykues konstaton se burimi i krijimit të shumës së tërhequr prej 915.000 lekësh më datë 25.10.2013, në “Credins Bank”, është i akumuluar nga pagat e subjektit të rivlerësimit. Nga dita e tërheqjes së shumës dhe deri në përdorimin e saj, në kryerjen e pagesës së këstit të parë në datën 03.01.2014, për blerjen e automjetit tip “Citroen DS3”, vërehet se është një periudhë relativisht e shkurtër (rreth 70 ditë kalendarike).

12.9. Në vlerësim të rrethanave dhe fakteve se kjo shumë është përdorur vetëm dy ditë pas datës 31 dhjetor që mbulonte periudhën e deklarin vjetor, subjekti i rivlerësimit rezultonte me bilanc pozitiv për këtë vit, si dhe shuma prej 915.000 lekësh kishte një prejardhje nga një burim i ligjshëm, siç ishin pagat e saj, trupi gjykues vlerësoi ta konsiderojë atë si gjendje *cash* në fund të vitit 2013. Në vlerësimin e trupit gjykues, për të konsideruar mosdeklarimin e kësaj shume si gjendje *cash* në fund të vitit 2013, merr rëndësi të posaçme koha e shpenzimit të kësaj shume, përpos faktit se nga analiza financiare rezulton se subjekti kishte mundësi për të kursyer këtë shumë të tërhequr nga banka në datën 25.10.2013. Shpenzimi i saj për pagimin e këstit të parë të automjetit rezulton të ketë ndodhur në datën 3 janar 2014, rrethanë që duket si një zgjatim i situatës financiare të vitit që sapo ka kaluar, duke qenë se aktiviteti i zakonshëm funksional i institucioneve dhe jetës ekonomike në vend sapo ka filluar. Në këtë kontekst, trupi gjykues

vlerëson se për shkak të kësaj afërsie në datën 31 dhjetor 2013, të ardhurat e përdorura për këtë financim, logjikshëm e kanë burimin nga viti i mëparshëm në të cilin subjekti kishte mundësi të zotëronte këtë shumë. Me fjalë të tjera, nëse ky veprim financiar do të kryhej dy ditë më parë, situata nuk do të përbënte asnjë çështje për diskutim për organet e rivlerësimit, në rrethanat e renditura më lart. Për këto arsye, trupi gjykues çmon se kjo situatë duhet të vlerësohet objektivisht dhe mosdeklarimi i gjendjes *cash*, në DPV-në e vitit 2013, e cila është përdorur në ditët e para të vitit 2014, të konsiderohet si një pasaktësi që nuk duhet të afektojë vlerësimin e burimeve të kësaj pasurie, edhe duke ndjekur të njëjtin standard që Komisioni ka ndjekur në pasurinë tjetër të përshkruar më lart.

12.10. Në vijim të këtij arsyetimi, Kolegji korrigjoi analizën financiare të kryer në Komision, duke përdorur konkluzionin e mësipërm se likuiditetet e tërhequra prej subjektit në datën 25.10.2013, nga llogaria e pagës në “Credins Bank”, në vlerën prej 915.300 lekësh, të cilat konfirmohen edhe nga analiza financiare pozitive e kryer nga Komisioni për vitin 2013, me një mundësi potenciale për disponibilitet të gjendjes *cash* në vlerën prej 3.904.924 lekësh e të përdorura vetëm dy ditë pas ndërtimit të kësaj analize me referencë fundin e vitit 2013, do të duhen të konsiderohen si burim i ligjshëm i përdorur për financimin e këtij kësti, nga e cila rezultoi se subjekti ka pasur mundësi të kursente vlerën 1.515.844 lekë (10.812³² euro) dhe të paguante në datën 03.01.2014 këstin e parë të kësaj pasurie në vlerën 10.000 euro.

12.11. Në përfundim, për pasurinë automjet tip “Citroen DS3”, blerë në vitin 2014, në vlerën 18.000 euro, trupi gjykues i Kolegjit arriti në konkluzionin se qëndrimi i Komisionit se subjekti gjendet në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për financimin e kësaj të parë të paguar për këtë pasuri në datën 03.01.2014, në vlerën prej 966.243 lekësh, është i gabuar dhe rezultat i një analize jo objektive e konsistente të Komisionit.

13. Në përfundim të ankimit të paraqitur në Kolegji, subjekti i rivlerësimit, pasi paraqet në formë tabelare analizën financiare³³ të saj për vitet 2003-2016, pretendon se ka pasur një bilanc pozitiv (me përjashtim të vitit 2008, në të cilin rezulton një balancë negative 168.097 lekë). Subjekti pretendon se Komisioni nuk ka bërë një analizë gjithëpërfshirëse të rrethanave dhe provave të paraqitura prej saj, duke mosrespektuar në këtë mënyrë parimin e proporcionalitetit³⁴ dhe shkakun kushtetues që të justifikonte dhënien e masës disiplinore ndaj saj.

³² Konvertuar me kursin e Bankës Shqipërisë, datë 31.12.2013, k. K. 140.20.

³³ Analizë e detajuar financiare në faqen 26 të ankimit.

³⁴ Subjekti i rivlerësimit në mbështetje të këtij argumenti paraqet vendimmarrje të Komisionit, konkretisht në vendimin nr. 188, datë 24.07.2019, në të cilin citohet se: “Për rrjedhojë, trupi gjykues çmon se bilanci përfundimtar, i konstatuar në vlerën negative prej 1.170.217 lekësh, në këtë rast - duke pasur parasysh edhe funksionin e mbuluar në të kaluarën profesionale nga subjekti - në vetvete dhe në tërësinë e fakteve dhe rrethanave, nuk vlerësohet shkak i mjaftueshëm që të pasjellë zbatimin e pikës 3, të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, pasi për sa i përket përlllogaritjeve dhe rezultateve financiare - të cilat kryhen nëpërmjet një analize të thelluar, strikte dhe gjithëpërfshirëse - ato duhet të vlerësohen në harmoni me kuadrin e plotë të rrethanave dhe provave të arritura, si dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit”.

Vendimin nr. 152, datë 07.06.2019 të Komisionit në të cilën citohet se: “Komisioni vlerëson se pasaktësia e konstatuar për mosdeklarimin në vitin 2015 të shumës *cash* prej 10.000 euro, gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit nuk ndikon në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit e nuk cenon figurën e prokurorit dhe nuk ka cenuar besimin e publikut të drejtësia”.

13.1. Në funksion të shkakut të ankimit të mësipërm, trupi gjykues vlerëson se zbatimi i parimit të objektivitetit dhe i parimit të proporcionalitetit, në vlerësimin e kriterit pasuror, duhet të verifikohen rast pas rasti, bazuar në evidentimin e rrethanave objektive që dalin nga aktet e administruara në fashikujt e procedurës së rivlerësimit dhe, pasi këto rrethana vendosen përballë përfundimeve të arritura mbi mjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme financiare të krijimit të pasurisë, për të konkluduar nëse gjen vend zbatimi i këtyre parimeve.

13.2. Në analizë të vendimit objekt shqyrtimi, trupi gjykues konstaton se pasaktësitë dhe pamjaftueshmëritë në burimin e krijimit të pasurisë nga subjekti i rivlerësimit janë evidentuar kryesisht në periudhën 1994-2002, periudhë e cila për shkak të kontekstit të kohës ka prodhuar mangësi në mbajtjen e dokumentacionit nga subjekti. Referuar analizës financiare të kryer në Komision, rezulton se për periudhën 2003-2016, subjekti i rivlerësimit ka balancë pozitive për çdo vit të analizës, përveç vitit 2008, ku rezulton me pamundësi financiare në shumën 168.097 lekë. Trupi gjykues, duke konsideruar këtë shumë të pashoqëruar me shkaqe të tjera që lidhen me kriterin e kontrollit të pasurisë, për periudhën e rivlerësimit 2003-2016, vlerëson se nuk do të duhej të gjente vend zbatimi i nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016 dhe nuk do të ishte proporcionale të konsiderohej pikërisht kjo shumë si mungesë të ardhurash me burim të ligjshëm, që do ta çonte subjektin drejt zbatimit të masës disiplinore të shkarkimit.

14. Në kushtet e mësipërme, në vlerësimin e trupit gjykues e vetnja pasuri e subjektit të rivlerësimit, e cila rezultoi me mungesë të burimeve të ligjshme, është ajo e ndodhur në Tiranë, me një balancë negative prej 1.673.375 lekësh, balancë e cila në çmimin e trupës gjykuese thërret për vlerësim zbatimin e parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, sipas parashikimit të nenit 4, pika 5 dhe nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për sa kohë që e gjithë situata financiare e subjektit për të gjithë periudhën pas vitit 2003, kur për subjektin ka lindur detyrimi për deklarim të pasurisë, rezulton e shëndetshme, me të ardhura të konsiderueshme e shpenzime të cilat përballohen lehtësisht prej tyre.
15. Trupi gjykues vëren *së pari*, se kjo mungesë vjen për shkak të faktit se subjekti ka dështuar të provojë se si burim për pagimin e dy kësteve të para të çmimit të pasurisë apartament të paguara në tetor 2002 dhe shkurt 2003 ka shërbyer fillimisht një hua e dhënë prej familjarëve të saj, e cila i është kthyer më pas atyre, pas marrjes së kredisë për blerjen e apartamentit, të deklaruar si burim për krijimin e tij në deklaratimet e deklaratës fillestare në vitin 2003 dhe në deklaratën *vetting*. Mosdeklarimi i kësaj huaje në deklaratën fillestare duket se lidhet me moskuptimin qartë të parashikimeve ligjore, të cilat sapo kishin hyrë në fuqi, si edhe me faktin që në kohën e këtij deklarimi kjo hua, sipas pretendimeve të subjektit, ishte shlyer dhe tashmë kredia kishte zënë vendin e burimit të krijimit të kësaj pasurie, burim i cili është vlerësuar prej subjektit si i tillë edhe në deklaratën *vetting*. Ndonëse trupi gjykues nuk i konsideroi si të provuara këto deklarime të subjektit, rrethanat faktike në të cilat këto deklarime kanë munguar të kryhen, mbeten elementë të cilat vlerësohen në kuadër të zbatimit të parimit të objektivitetit, për të konkluduar për peshën e balancës negative në procesin e rivlerësimit.

16. Krahas kësaj rrethane, konstatohet se subjekti i rivlerësimit ka përpiluar dhe nënshkruar kontratën e shitblerjes së apartamentit në datën 31.01.2019, në përmbajtje të së cilës ka përcaktuar edhe modalitetet dhe kalendarin e pagesave për këstet e apartamentit, duke përcaktuar një kalendar, i cili duke qenë se është hartuar brenda këtij akti, në mënyrë atipike dhe të panevojshme, mund të ishte ndërtuar prej subjektit në favor të një analizë pozitive të saj, aq më tepër kur procesi i rivlerësimit kalimtar kishte nisur zbatimin e tij që prej vitit 2017. Subjekti rezulton të mos e ketë shfrytëzuar kontratën e shitblerjes së përpiluar në një kohë të largët dhe me vullnet të lirë për të justifikuar burimet e krijimit të pasurisë, por duket se ka bërë në të një rrëfim të sinqertë të modaliteteve të pagimit të kësteve, duke përcjellë një indicie rreth vërtetësisë së deklarimeve të saj për burimet e krijimit të pasurisë. Gjithashtu, siç u arsyetua më lart, pasi Kolegji kontrolloi analizën financiare të kryer nga Komisioni, për mundësinë e familjarëve të subjektit për t'i huazuar asaj shumë prej 17.000 USD/2.000.000 lekë, për periudhën kohore tetor 2002-shkurt 2003, sipas standardit të vendosur nga jurisprudenca e Kolegjit e të zbatuar përgjithësisht për çdo subjekt rivlerësimi, rezultoi se ata kishin mundësi të krijonin këtë shumë me burime të ligjshme. Në këto kushte, ndonëse Kolegji në referim të standardeve të konsoliduara tashmë rreth vërtetësisë së deklarimeve, arriti në konkluzionin se subjekti nuk e provoi ekzistencën e kësaj marrëdhënieje, e cila ka prodhuar balancën negative të marrë në konsideratë, rrethanat e mësipërme vlerësohen në peshën që kjo balancë negative duhet të ketë në procesin e rivlerësimit të subjektit.
17. Kjo situatë u vlerësua nga trupi gjykues në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, në konsideratë të faktit se pasuria është krijuar në kushtet kur ligji nr. 9049/2003 nuk ishte miratuar ende dhe nuk kishte tërhequr vëmendjen e subjekteve deklarues rreth deklarimeve të detajuara e të kujdesshme për burimet e krijimit të pasurive, si edhe faktit që në momentin e deklaratës fillestare, pjesa e kredisë që mbulonte pikërisht dy këstet e para ishte disbursuar dhe bërë efektive. Për pasojë, balanca negative, si problematika e mbetur e vetme dhe pa asnjë çështje tjetër të konstatuar përgjatë gjithë periudhës së rivlerësimit 2003-2016, nuk është vlerësuar prej trupit gjykues se është e mjaftueshme për të konkluduar që subjekti gjendet në kushtet e një deklarimi të pamjaftueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë nën dritën e nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
18. Në kushtet kur subjekti ka rritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1, germa “b” dhe nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 59, pika 1 germa “c” e ligjit nr. 84/2016, Kolegji arrin në konkluzionin se vendimi i Komisionit objekt shqyrtimi nuk është i drejtë e, për pasojë, ai duhet të ndryshohet.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

1. Ndryshimin e vendimit nr. 350, datë 23.02.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Mariana Shegani.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 30.01.2024.

ANËTARE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi-kundër

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi-kundër

KRYESUESE

Ina RAMA

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë gjyqtarja Rezarta Schuetz nuk isha dakord me shumicën e trupit gjykues dhe, për pasojë, votova kundër konfirmimit në detyrë të subjektit të rivlerësimit Mariana Shegani. Në vlerësimin tim, subjekti i rivlerësimit nuk është e besueshme në kriterin e vlerësimit të pasurisë e, për pasojë, vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) duhet të ishte lënë në fuqi. Në vijim shtjellohet arsyetimi, mbi të cilin mbështetet qëndrimi im.
2. Komisioni ka konstatuar se subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë e të pamjaftueshëm, pasi ka konstatuar një balancë negative në vlerën prej afërsisht 4 milionë lekë, për të justifikuar pasuritë e shpenzimet ndër vite. Për pasojë, Komisioni ka konkluduar se subjekti nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimeve të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Edhe në vlerësimin tim, subjekti gjendet në kushtet e deklarimit të pasaktë e të pamjaftueshëm, sikurse edhe të mungesës së burimeve të ligjshme për të krijuar pasuritë dhe mbuluar shpenzimet, parashikuar nga neni 33, pika 5, gjerat “a” dhe “b”, përkatësisht. Edhe duke pranuar, për shkak të rrethanave të kohës së shkurtër mes tërheqjes së vlerës nga depozitat bankare deri në blerjen e një automjeti në vitin 2014, sërish subjekti rezultoi me mungesë burimesh, minimalisht në vlerën 2.3 milionë lekë, në analizën e kryer në Kolegj. Për pasojë, në kushtet që edhe duke pranuar pretendimet e subjektit, ajo gjendet në një mungesë të konsiderueshme burimesh të ligjshme për krijimin e pasurive, ndaj qëndrim të ndryshëm nga shumica dhe votova që shkarkimi i subjektit të mbetet në fuqi, me arsyetimin në vijim.
3. Vendimi i Komisionit bazohet kryesisht në analizën e burimeve të ligjshme dhe pasaktësinë e deklarimeve të subjektit për krijimin e një apartamenti në Tiranë, një apartamenti në plazh në Kavajë dhe një automjeti. Ndërkohë, Komisioni, pasi i ka kaluar barrën e provës për probleme me disa pasuri të tjera, ka pranuar shpjegimet e subjektit për to. Ndër pasuritë me probleme që kanë pasjellë edhe masën disiplinore të shkarkimi janë dy apartamente të porositura në vitin 2002 dhe së fundmi një automjet i blerë në vitin 2014. Në vijim shtjellohet në detaj vlerësimi im për secilën nga këto aspekte të vlerësimit pasuror të subjektit.

*I. Apartamenti në rrugën “{***}”, në Tiranë*

4. Subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti kanë nënshkruar një kontratë porosie në datën 31.10.2002, për një apartament me sipërfaqe 113 m², me vlerë 52.000 USD. Në deklaratën e pasurisë për rivlerësimin [deklarata *vetting*], sikurse edhe në deklaratën periodike vjetore për vitin 2003, subjekti ka deklaruar si burim krijimi *kredi* bankare. Gjatë hetimit administrativ, sikurse edhe nga aktkontrolli i hartuar nga ILDKPKI-ja, ka rezultuar se në fakt kontrata e kredisë së nënshkruar në datën 25.07.2003 është akorduar në pjesë si vijon: 17.500 USD më 06.08.2003, 24.500 USD më 07.12.2004 dhe kësti i fundit prej 10.000 USD më 06.12.2006. Nga ana tjetër, pagesat për apartamentin – referuar kontratës së shitjes [datë 31.01.2019] – janë kryer të gjitha brenda datës 07.12.2004. Sjell në vëmendje, që kontrata e sipërmarrjes ka përcaktuar një kalendar tjetër pagesash, i cili gjithsesi nuk përkon me lëvrimet e kredisë.
5. Në analizë të këtyre dy kontratave [porosisë dhe asaj të shitjes], rezulton se subjekti ka paguar 10.000 USD ose 15.000 USD, *përpara* se të hartohet kontrata e porosisë, sipas të dy akteve, shlyerja e të gjithë vlerës do të kryhej/u krye brenda dhjetorit 2004. Me fjalë të tjera, kontrata e kredisë nuk ka shërbyer për krijimin e pasurisë, pavarësisht nga cili prej kalendarëve të pagesave pranohet ai real. Nga hetimi ka rezultuar se vetëm një ndër pagesat, ajo e kryer më 07.12.2004, përkon me sa referon kalendar i

pagesave, sipas kontratës së shitjes. Nga ana tjetër, një pjesë e fondeve të kredisë, në vlerën prej përreth 15.500 USD, nuk është tërhequr *asnjëherë* dhe përdoret për të paguar këstet e vetë kredisë. Pyetur gjatë hetimit administrativ për kalendarin e pagesave dhe burimin e krijimit të pasurisë, pasi Komisioni konstatoi mospërputhjet e mësipërme, në pyetësin nr. 2, subjekti ka theksuar sërish *kredinë* si burim, dhe pagesat sipas kontratës së shitjes³⁵.

6. Nga sa më sipër, deduktohet se edhe sipas variantit të pagesave të pontencuara prej subjektit, më 25.11.2020, 17.000 USD janë paguar përpara marrjes së kredisë e, për rrjedhojë, kredia është përdorur vetëm për një pagesë që përbën përreth 50% të vlerës së paguar prej subjektit³⁶ – atë të kryer në dhjetor 2004, në vlerën 23.329 USD – ndërsa pjesa tjetër e kredisë nuk ka shërbyer si burim krijimi i apartamentit objekt analize. Pagesat sipas shpjegimeve të subjektit kundrejt kontratës së shitjes kanë edhe mospërputhje të tjera, të cilat e bëjnë subjektin dhe situatën e përshkruar prej saj me kontradikta e të pabesueshme. Konkretisht, nga transhi i parë i kredisë në vlerën 17.500 USD, disbursuar në 6 gusht 2003, subjekti rezultoi të ketë tërhequr në total vlerën 12.000 USD më 2 tetor 2003 dhe 19 nëntor 2003 [6.000 USD secilën datë respektivisht]. Ndër këto dy shuma, vetëm njëra përkon në kohë dhe vlerë me kalendarin e pagesave sipas kontratës. Qartazi, tërheqja e dytë nga kredia nuk ka pasur për qëllim pagesa për këtë pasuri.
7. Pretendimet e subjektit gjatë hetimit administrativ, në nëntor 2020, se në fakt dy pagesat e para janë mbuluar me hua të marrë nga e motra, në vlerën 2.000.000 lekë, janë jobindëse. *Së pari*, pasi për herë të parë, sjellja në pah e huas nga motra ka ardhur në hetimin administrativ, ndërkohë që nuk ka asnjë dokument të kohës ose të viteve vijuese nga të cilat mund të deduktohet qoftë edhe indirekt për ekzistencën e kësaj marrëdhënieje huaje. *Së dyti*, edhe deklarata noteriale e motrës, hartuar në datën 09.09.2020, përpos faktit që është kryer gjatë hetimit administrativ dhe, për pasojë, me vlerë të kufizuar provuese, referon të ardhura të cila huadhënësja vetë nuk i kishte fituar ende në momentin në fjalë, sikurse edhe sjell në fotografi edhe një person tjetër të lidhur, vëllanë emigrant.
8. Motra e subjektit referon dhënien e huas në funksion të pagesave të kryera në tetor 2002 dhe shkurt 2003, duke pretenduar të ardhura nga një shitje e kryer prej saj në shtator 2003, thuhet një vit pasi ka dhënë huan. Së dyti, nuk ka asnjë gjurmë të secilit transaksion, qoftë të huas së dhënë apo edhe kthimit të saj. Subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë asnjë detyrim financiar ndaj familjes së origjinës apo motrës në mënyrë specifike në harkun kohor 2003-2008. Këtë shpjegim, subjekti e ka dhënë për herë të parë në pyetësin nr. 4, në Komision. Me fjalë të tjera, jo vetëm që subjekti nuk ka treguar saktë burimin e krijimit të pasurisë në mënyrë të vazhdueshme, duke kryer në këtë mënyrë deklaram të rremë në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, por edhe burimet e deklaruara rishtazi në hetimin administrativ janë jobindëse e të pabesueshme.
9. Për rrjedhojë, shpjegimet e subjektit kam vlerësuar se janë të pabesueshme dhe konkluzioni i Komisionit duhet të ishte lënë në fuqi. Në analizën e kryer nga Kolegji, në funksion të kontrollit të analizës së Komisionit, subjekti rezultoi me pamundësi për të paguar dy këstet e para të kësaj pasurie në vlerën 1.673.342 lekë. Bashkë me deklaramin e pavërtetë për burimin e krijimit të kësaj pasurie, në vlerësimin tim, subjekti gjendet në kushtet e nenit 33, pika 5, germa “b” dhe minimalisht edhe të germës “a”, të ligjit nr. 84/2016, për mungesë burimesh dhe pasaktësi në deklaram.

³⁵ Sipas kësaj kontrate, pagesat e kryera janë respektivisht 10.000 USD më 10 tetor 2002, 7.000 USD më 15 shkurt 2003, 6.000 USD më 3 tetor 2003 dhe 23.329 USD më 7 dhjetor 2004, në total 46.329 USD. Diferenca prej 4.500 USD [afërsisht], zbritur nga çmimi me dakordësi të palëve për pajisjet hidrosanitare, sipas shpjegimit të subjektit në pyetësorë.

³⁶ Subjekti ka shpjeguar se në fakt ka paguar vetëm vlerën 46.329 USD dhe jo gjithë vlerën prej 52.000 USD për ndërtesin. Analizuar në faqen 5 të vendimit të Komisionit.

II. Apartamenti në plazh Kavajë

10. Komisioni ka konstatuar se subjekti është në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme edhe për krijimin e një apartamenti me sipërfaqe 87,5 m², në {***}, Kavajë, porositur më 17.03.2008 dhe blerë më 03.12.2015 në vlerën 35.000 euro dhe 335.000 lekë. Subjekti ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie shitjen e një apartamenti tjetër, në të njëjtin vend, me vlerë 27.000 euro në vitin 2007 dhe të ardhura nga pagat. Komisioni ka hetuar për burimet e deklaruara të krijimit të apartamentit që ka shërbyer si burim dhe nga analiza financiare i ka rezultuar një mungesë burimesh për krijimin e apartamentit. Ndaj të njëjtin qëndrim me Komisionin edhe për vlerësimin për këtë pasuri.
11. Subjekti ka deklaruar vlerën e apartamentit pasaktësisht, duke ulur vlerën nga 3.600.000 lekë në 2.600.000 lekë dhe si burim kursimet nga paga dhe *ndihma nga anëtarët e familjes*, në deklaratën periodike të vitit 2003. Gjatë hetimit administrativ, subjekti ka pretenduar se vlera e vendosur me 1.000.000 lekë më pak krahasuar me kontratën përbënte një lapsus. Për sa i përket burimeve të krijimit, subjekti ka deklaruar se me "*ndihmë nga anëtarët e familjes*" ka pasur parasysh një shumë të ardhurash të dhuruara personit të lidhur [dhe vetë subjektit] nga prindërit e tij çdo muaj, të fituara prej tyre nga qiradhënia e një pjese të shtëpisë së tyre një individ të huaj në periudhën 1994-1998, në vlerën 500 USD në muaj. Në total, sipas saj, prindërit e bashkëshortit i kanë dhuruar 24.000 USD.
12. E vlerësoma të bazuar konkluzionin e Komisionit për mosmarrjen në konsideratë të kësaj shume të pretenduar të përfituar nga subjekti për disa arsye. Sikurse edhe Komisioni arsyeton në paragrafin 3.23 të vendimit, subjekti nuk provoi asnjë aspekt të qiradhënies me dokumentacion, përfshirë marrëdhënien e qirasë, shumën e fituar dhe dhurimet e rregullta mujore të pretenduara, të cilat mbetën deklarative, në kushtet që subjekti nuk ka deklaruar asnjëherë, qoftë në deklaratën e parë periodike vjetore apo në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, fitimin e një shume monetare të konsiderueshme, sidomos krahasuar me të ardhurat mujore të saj dhe të personit të lidhur. Konkretisht, ndërsa në deklaratën e pasurisë së rivlerësimit, subjekti ka deklaruar në detaj të ardhura duke filluar nga viti 1992, përfshirë edhe një vlerë modeste prej 120.000 lekësh nga shitja në vitin 2005 e një automjeti të blerë në vitin 1996, vlera e konsiderueshme prej 24.000 USD, një ndër të ardhurat më të larta të pretenduara prej saj, nuk ka gjetur *asnjë* pasqyrim, pavarësisht se në vitet përkatëse përbënte një dhurim mujor që prevalonte mbi të ardhurat e saj dhe bashkëshortit nga pagat. Çmova se edhe për këtë pretendim subjekti nuk është bindëse dhe as ka parashtruar detaje specifike nga të cilat të arsyetohej indirekt për ekzistencën e kësaj shume në kohën kur është krijuar pasuria objekt analize. Së fundmi, duke abstraguuar nga dinamika e kujt i përkiste detyrimi për pagesën e detyrimeve tatimore, shlyerja e tyre nga subjekti në vitin 2021, gjatë hetimit administrativ, sikurse ka vlerësuar edhe Komisioni, nuk mund të shërojë problematikën e moskonfirmimit të ekzistencës së këtyre të ardhurave dhe efektin e ligjshmërisë së tyre në kohën kur dhurimet kanë krijuar pasojat pozitive financiare për subjektin dhe personin e lidhur.
13. Nga analiza e kryer në Kolegj, vlera negative e konstatuar për të krijuar pasurinë në fjalë dhe kryer shpenzimet, me korrigjimet përkatëse, rezulton në vlerën 447.298 lekë, përkundër (-) 1.354.372 lekë. Dy aspektet e pasurisë së vlerësuar më sipër, sikurse edhe balanca negative e konstatuar nga analiza e kryer nga Komisioni për vitin 2008, rezultojnë në një balancë negative në total prej gati 2.3 milionë lekësh, për krijimin e pasurive dhe përbalimin e shpenzimeve. Në këtë analizë, nuk përfshihet balanca negative që do të rezultonte nëse përfshihej analiza e vlerësimi i kryer nga Komisioni, për blerjen e një automjeti nga personi i lidhur në janar 2014³⁷. Nëse në analizë do të përfshihej edhe ajo balancë negative, në kushtet që subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar gjendjen *cash* të likuiditeteve

³⁷ Analizuar nga Komisioni në vendim në faqet 20-26.

në fund të vitit 2013, pavarësisht nga detyrimi që rrjedh nga neni 4 pika 1, germa “d” e ligjit nr. 4049/2003 – potencuar në mënyrë të vazhdueshme edhe në vendimet e Kolegjit si mënyra e vetme nëpërmjet të cilës mund të provohet ekzistenca e likuiditeteve jashtë sistemit bankar, mungesa e burimeve do të ishte 3.2 milionë lekë [rumbullakosur].

GJYQTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

MENDIM PAKICE

1. Unë, anëtari i trupit gjykues Sokol Çomo, në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, në përfundim të shqyrtimit të çështjes, kam votuar për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 350, datë 23.02.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Mariana Shegani (Dedi), dhe shkarkimin e saj nga detyra. Ky qëndrim është bazuar në vlerësimin tim se subjekti i rivlerësimit, znj. Mariana Shegani (Dedi), nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë për arsyet e mëposhtme.
2. Lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 113 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, kam arritur në konkluzion të njëjtë me shumicën e trupit gjykues dhe bazuar në të njëjtat shkaqe të treguara prej saj në arsyetimin e vendimit se, me të drejtë, Komisioni nuk ka përfshirë në analizën financiare të kryer prej tij huanë e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si të marrë prej motrës së saj, znj. N. D., në vitin 2002, në shumën e 2.000.000 lekëve, duke qenë se nuk e ka njohur këtë shumë si burim për pagimin e dy kësteve të shlyera për apartamentin në vitin 2002. Si rrjedhojë e sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, znj. Mariana Shegani (Dedi), ka rezultuar me balancë negative në vlerën (-)1.673.375 lekë, për të justifikuar me burime të ligjshme këtë pasuri, situatë e cila e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e parashikuara prej nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
3. Në ndryshim nga shumica e trupit gjykues, e cila vlerësoi se mungesa e burimeve të ligjshme – e trajtuar më lart, në zbatim të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit, sipas parashikimeve të nenit 4, pika 5 dhe nenit 52, pika 1 e ligjit nr. 84/2016 – nuk cenon arritjen e një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, kam çmuar se kjo mungesë e burimeve të ligjshme, e lidhur e gjitha me një pasuri të vetme dhe me një peshë të konsiderueshme në vlerën totale të kësaj pasurie, si dhe pretendimi i një situatë faktike të pabesueshme lidhur me huanë e marrë znj. N. D., vetëm gjatë hetimit administrativ, e vendos subjektin e rivlerësimit në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm të kësaj pasurie, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 33, pika 5, germa “b” dhe 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.
4. Në përfundim, megjithëse nuk kam kundërshtime për konkluzionet e arritura nga shumica e trupit gjykues lidhur me pasurinë e paluajtshme të llojit “apartament”, me sipërfaqe 45,5 m², të ndodhur në {***}, Kavajë, dhe pasurinë e luajtshme të llojit automjet “Citroen DS3”, vlerësoj se për shkak të konkluzionit të arritur si më sipër, lidhur me pasurinë e paluajtshme “apartament banimi”, me sipërfaqe 113 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit, znj. Mariana Shegani (Dedi), nuk arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë së saj dhe të personave të lidhur me të, në kuptim të nenit 59, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016 dhe, si pasojë, nuk duhej të konfirmohej në detyrë.

5. Për sa më sipër, kam votuar për lënien në fuqi të vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit nr. 350, datë 23.02.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Mariana Shegani (Dedi).

GJYQTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi